



CEZ SHPËRNDARJE

Aplikimi i Tarifave për 2012 - 2014

**Aplikimi i tarifave për OSSH dhe FPP për
2012 - 2014**

**CEZ Shpërndarje, sh.a.
Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1
Tirana
Shqipëri**

Përmbajtja

1. Permbledhje	5
2. Taksat	7
3. Indeksi i çmimit të konsumatorit	7
4. Norma e kursit valutor.....	8
5. Përcaktimi i çmimeve të FPSH OST për periudhën 2012 – 2014	9
5.1. Çmimi i përdorur për FPSH dhe OST <i>për periudhën 2012 – 2014</i>	9
6. Kërkesa për energji në lidhje me aplikimin e tarifave	10
6.1. Kërkesa për energji dhe numri i konsumatorve i parashikuar për vitet 2011 dhe 2012.....	10
6.1.1. Metodologjia e përdorur	10
6.1.2. Konsumatorët e lidhur në rrjetin e TL (përfshirë 220 kV dhe 110 kV)	10
6.1.2.1. Parashikimi për konsumatorët në TL për H2 2011	11
6.1.2.2. Parashikimi për konsumatorët në TL për 2012	11
6.1.3. Konsumatorët të lidhur në 35 kV	12
6.1.4. Konsumatorët të lidhur në 20/10/6 kV.....	15
6.1.5. Konsumatorët jofamiljarë në nivel tensioni 0.4 kV (duke përjashtuar familjarët)	17
6.1.6. Konsumatorët familjarë.....	20
6.1.7. Dëmi ekonomik në TU	25
6.2. Parashikimi i kërkesës për energji për vitet 2013 dhe 2014	25
6.3. <i>Humbjet dhe çmimi i energjisë së importuar për periudhën 2012 – 2014</i>	26
6.3.1. Çmimi i energjisë së importuar	26
6.3.2. Programimi i humbjeve	27
7. OPEX (Shpenzimet Operative).....	29
7.1. <i>Përmbledhje e aktiviteve të mëparshme</i>	29
7.1.1. <i>Aktivitetet e kryera në Administrimin e Përgjithshëm</i>	29
7.1.2. <i>Aktivitetet në Divizionin e Shitjeve</i>	29
7.1.3. <i>Aktivitetet në Divizionin e Shpërndarjes</i>	32
7.1.4. <i>Aktivitetet në Administrimin e Përgjithshëm</i>	34

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

7.2.	<i>Ristrukturimi i organizimit të kompanisë dhe koncepti i shërbimeve të përbashkëta</i>	35
7.2.1.	Organizimi i Kompanisë në vitin 2011	35
7.2.2.	Organizimi i Kompanisë në vitet 2012 – 2014	35
7.3.	<i>Shpenzimet personale</i>	36
7.3.1.	Parashikimi i kostove personale për 2012	36
7.4.	<i>OPEX të tjera për 2012 -2014</i>	36
7.4.1.	OPEX të tjera – aktivitete të reja në OSSH	36
7.4.2.	OPEX të tjera – aktivitete të reja në FPP	39
7.4.3.	OPEX të tjera– aktivitete të reja në Administrimin e Përgjithshëm	43
7.4.4.	OPEX të tjera – aktivitete të pallogaritura	44
7.5.	<i>Parimet e alokimit për alokimin e kostove ndërmjet OSSH & PFF</i>	45
7.6.	<i>Përmbledhje e përgjithshme e OPEX</i>	46
8.	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	46
8.1.	<i>OPEX</i>	46
8.2.	<i>CAPEX</i>	46
8.2.1.	CAPEX 2010	47
8.2.2.	Parashikimi i CAPEX 2011	48
8.2.3.	Parashikimi i CAPEX 2012	49
8.2.4.	Parashikimi i CAPEX 2013 – 2014	50
8.3.	<i>Amortizimi</i>	52
8.3.1.	Amortizimin për vitet 2008 – 2011.....	52
8.3.2.	Amortizimin për vitin 2012.....	56
8.3.3.	Amortizimin për vitin 2013.....	57
8.3.4.	Amortizimin për vitin 2014.....	58
8.3.5.	Amortizimi i aseteve për qëllime llogaritjeje të tarifës	60
8.4.	<i>Llogaritja e peshës së ponderuar të kostos së kapitalit (WACC)</i>	60
8.4.1.	Llogaritja e kthimit të lëjuar të kapitalit	60
8.4.2.	Kosto e borxheve të vjetra	60
8.4.3.	Kosto e borxheve të reja.....	61
8.4.4.	Formula e llogaritjes së WACC.....	62

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

8.5.	<i>Kapitali i punes</i>	63
8.6.	<i>Baza e asetit të rregulluar</i>	63
8.6.1	<i>Baza e asetit të rregulluar (RAB) për 2012</i>	63
8.6.2.	<i>Baza e asetit të rregulluar (RAB) për 2013</i>	64
8.6.3.	<i>Baza e asetit të rregulluar (RAB) për 2014</i>	65
8.6.4.	<i>Llogratija e bazës e asetit të rregulluar (RAB) për 2012, 2013 dhe 2014</i>	66
9.	<i>Furnizuesi Publik me Pakicë</i>	67
9.1.	<i>OPEX</i>	67
9.2.	<i>Borxhet e Këqija</i>	67
9.3.	<i>Marzhi i RPS</i>	68
10.	<i>Mekanizmi i kompensimit</i>	68
10.1.	<i>Kompensimi i Borxhit të Keq për 2009, 2010 dhe 2011</i>	69
10.2.	<i>Kompensimi i kostove të blerjes së humbjeve për 2011</i>	70
10.3.	<i>Kompensimi i diferencës midis planit dhe parashikimit të ti të kërkesës për 2011</i>	71
10.4.	<i>Kompensimi i vlerës së asetëve për 2011 nga investime të ndryshme për 2011</i>	72
10.5.	<i>Kompensimi i amortizimit të asetëve të blera para privatizimit</i>	72
10.6.	<i>Perlllogaritja totale e kompensimit per vitet 2009, 2010 dhe 2011</i>	73
10.7.	<i>Kompensimi për vitet 2013 dhe 2014</i>	75
11.	<i>Kërkesa për të ardhura për 2011 dhe shpërndarja e tarifës</i>	75
11.1.	<i>Të ardhura të tjera</i>	75
11.2.	<i>Të ardhura nga energjia reaktive</i>	76
11.3.	<i>Të ardhura nga energjia në pik</i>	77
11.4.	<i>Paraqitja e komponentit te tarifes fike</i>	78
11.5.	<i>Korrigjimi i mbulimit të humbjeve të transformatorëve</i>	79
11.6.	<i>Parametrat fiks dhe variabël gjatë periudhës rregullatore</i>	80
11.7.	<i>Llogaritja e të ardhurave totale të kërkuara</i>	81
11.8.	<i>Refuzimet</i>	82
11.9.	<i>Mbështjetja e konsumatorëve në nevojë nëpërmjet tarifës së bllokut të parë</i>	83
11.10.	<i>Llogaritja e tarifave për kategoritë e konsumatorëve</i>	86
	Lista e shtojcave	89

1. Përmbledhje

Duke u bazuar në Deklaratën Rregullatore, seksioni 1.3, CEZ Shpërndarje sh.a (“CEZ Shpërndarje”), me anë të këtij dokumenti, paraqet Aplikimin e Tarifave për Periudhën e tretë Rregullatore (2012-2014). Aplikimi i tarifave është përgatitur në bazën e legjislacionit në fuqi. Ai respekton të gjitha formulat dhe parimet e Deklaratës Rregullatore.

Gjatë perilogaritjes së të Ardhurave të Kërkuara për Periudhën e tretë Rregullatore, kemi marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- (i) Çmimet për FPSH dhe OST, d.m.th KESH dhe OST, që janë inpute për OSSH dhe FPP, janë konsideruar si të qëndrueshëm/neutrale për perilogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara. Për pasojë, për qëllime të llogaritjes, janë marrë në konsideratë çmimet e vitit 2011.
- (ii) Çmimi i energjisë për mbulimin e humbjeve, duke përfshirë normën e pritshme të kursit valutor, bazohet në monitorimin e situatës aktuale të tregut dhe mund të ndryshojë gjatë periudhës së negociatave.
- (iii) Ne i kemi kushtuar vëmendje të veçantë parashikimit të kërkesës /konsumit për vitet në vijim. Jemi të bindur se modeli i hartuar nga, ne reflekton të gjitha parametrat që kanë impakt material mbi rezultatet përfundimtare. Sidoqoftë, nëse parametrat do të ndryshojnë në të ardhmen, ne jemi të gatshëm të rillogarisim parashikimin.
- (iv) Ne gjithashtu kemi marre ne konsiderate zhvillimin pozitiv të Shqipërisë dhe rritjen permanente të GDP (PPB). Gjithashtu marrim ne konsiderate arritjet pozitive të qeverisë Shqiptare, të cilat influencojnë në klimën e përgjithshme ekonomike në vend.
- (v) Ne gjithashtu i kushtojmë një vëmendje të duhur situatës financiare, ekonomike dhe politike në Europë e cila mund të influencojë situatën në tregjet e energjisë.

Duke marrë parasysh supozimet e mësipërme, sasia e parashikuar e energjisë për t’ju shpërndarë konsumatoreve është 5.4 TWh për vitin 2012.

Projektet e investimit përbëjnë një nga parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të rrjetit. Për fat të keq, për shkak të mungesës së disponimit të kredive afatgjata të investimeve, CEZ Shpërndarje sh.a nuk është në gjendje të përmbushë planin e investimeve të miratuar për vitin 2011. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk është dhënë deklarata e kërkuar nga bankat që duhej lëshuar nga autoritetet shqiptare. Gjithsesi, ne jemi të përgatitur për të investuar shumë e pa investuar të planit të vitin 2011 në të ardhmen dhe ta shtrijmë atë gjatë tri viteve në vazhdim, duke supozuar disponibilitetin e kredive. Me anën e këtij dokumenti, CEZ Shpërndarje sh.a, paraqet strategjinë e saj

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

të investimit për tri vitet në vijim dhe transformimin e saj pasues në projekte investimi. Investimet e parashikuara për Periudhën e tretë Rregullatore janë 20,2 miliardë LEK (rreth 145 mil. EURO). Këto investime, që përbëjnë parakushte për luftën e suksesshme ndaj humbjeve në rrjet, do t'u sjellin me siguri një vlerë të shtuar konsumatorëve, si dhe përmirësimeve të nevojshme në rrjetin e shpërndarjes së Shqipërisë.

Do të dëshironim të theksonim se shuma totale e Shpenzimeve Operacionale të kërkuar për 2012 (duke mos marrë parasysh projektet e reja të përshkruara më poshtë) janë madje më të ulëta sesa shuma e shpenzimeve të miratuara nga ERE për vitin 2011. Kjo e vërteton se masat për kursim të marra nga CEZ Shpërndarje kanë mbrojtur në mënyrë efektive konsumatorët nga impakti negativ i inflacionit.

Gjatë periudhës tre vjeçare, CEZ Shpërndarje sh.a do të dëshironte të paraqiste disa projekte të orientuara drejt konsumatorit. Sfera e projekteve të përzgjedhura është përgatitur duke u bazuar në kërkimet e ndërmarra që synojnë të rrisin dhe përmirësojnë shërbimet që u ofrohen konsumatorëve. Vec kësaj, duke marrë në konsideratë kërkesat e ligjit të ri nr. 10362 në lidhje me verifikimin e matjes, CEZ Shpërndarje s do t'i duhet të bëjë shpenzime operacionale shtesë në nivelin e 1,1 miliardë LEKË (rreth 3% të rritjes së tarifës) për të paguar palët e treta të licensuara të pavarura.

Gjithashtu, kostove të përmendura më sipër të projekteve të reja dhe cmimit të rritur të tregut të energjisë për mbulimin e humbjeve, duke përfshirë luhatjen e kursit të këmbimit, një nga faktorët që nxit rregullimin e tarifës është edhe kompensimi i borxhit të keq. Do të dëshironim të nënvizojmë se Deklarata Rregullatore na jep të drejtën të përfshijmë shumën e plotë në të ardhurat e kërkuara për vitin 2012. Pavarësisht kësaj, me qëllim që të mbrojmë konsumatorët shqiptarë nga ndryshime të papritura dhe domethënëse të çmimeve, do të dëshironim të propozojmë një shtrirje graduale të shumës për të gjithë Periudhën e plotë të tretë Rregullatore, gjë që do të kontribuonte në stabilizimin e zhvillimit të tarifave.

Gjithë sa u përmend më lart është marrë në konsideratë gjatë perilogaritjes së totalit të të Ardhurave të Kërkuara për tre vitet në vazhdim. Fiksimi i disa parametrave (p.sh. shpenzimet operacionale dhe kapitale) përbën një nga parimet themelore të periudhës rregullatore afatgjatë përderisa sjell stabilizim të mjedisit të biznesit. Parametra të tjera, që varen nga zhvillimi i tregut, do të rregullohen automatikisht çdo vit të periudhës rregullatore.

Do të dëshironim të theksonim faktin se CEZ Shpërndarje propozon përfshirjen e komponentit fiks, i cili është një pjesë standarde e strukturës së tarifave në shumë nga vendet e BE-së. Për më tepër, do të dëshironim të inicionim një diskutim mbi ristrukturimin e strukturës ekzistuese të tarifave, përderisa ajo nuk reflekton më realitetin ekonomik.

Duke marrë në konsideratë të gjitha këto fakte të rëndësishme, Kërkesat për të Ardhura kapin shifrën 54,1 miliardë lekë për vitin 2012. Kjo përfaqëson rritjen mesatare prej 4,58% në krahasim me tarifën mesatare të miratuar për vitin 2011.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Jemi në pritje për një dialog intensiv të ndërsjellë dhe diskutime me ERE-n në lidhje me Aplikimin e dorëzuar të Tarifave. Kemi besim të plotë se është në interesin tonë të përbashkët të arrijmë në një përfundim që të jetë i pranueshëm nga të gjitha palët e përfshira dhe do të garantojë zhvillim të mëtejshëm të rrjetit shqiptar të shpërndarjes, çka mund të arrihet vetëm nëpërmjet një modeli biznesi të qëndrueshëm dhe efikas.


2. Taksat

Norma taksore për biznesin në Shqipëri është në nivelin e 10 %. CEZ Shpërndarje e përdor këtë përqindje në perlllogaritjen WACC (Pesha e ponderuar e kostos së kapitalit) për vitet 2012 - 2014.

CEZ Shpërndarje është në dijeni se po përgatitet një draft amendues ndaj Ligjit mbi “Taksat mbi fitimin e bizneseve” në parlament. Ligji në fjalë propozon për kompanitë normë taksore progresive. Në rast të miratimit të këtij amendamenti, shoqëruar me ndryshime në Taksat mbi fitimin e bizneseve, ne do të dëshironim në nënvizionim faktin se CEZ Shpërndarje do të kërkojë një rillogaritje plotësuese të WACC.

3. Indeksi i çmimit të konsumatorit

Duke iu referuar faqes zyrtare të internetit të Institutit Shqiptar të Statistikave, Indeksi i Konsumatorit vit pas viti është në nivelin e 3.9% në qershor 2011. Tendenca për një periudhë afatgjatë tregohet në grafikun e mëposhtëm që është marrë nga i njëjti burim (<http://www.instat.gov.al>).



Sipas politikave monetare të Bankës së Shqipërisë (burimi: <http://www.bankofalbania.org>), fokusi i bankës për të arritur dhe mirëmbajtur stabilitetin e çmimeve, nënkupton ndjekjen e normave të ulëta, por pozitive të inflacionit, si edhe ruajtjen e tyre për periudha relativisht afatgjata. Në tema sasiorë,


Aplikimi i tarifave 2012-2014

Banka e Shqipërisë përcakton stabilitetin e çmimit duke ruajtur normën e inflacionit në 3.0 % me një kufi tolerance prej ± 1 përqind. Targeti i inflacionit do të matet nëpërmjet normës vjetore të ndryshimit në Indeksin e çmimit të konsumatorit, i llogaritur dhe i publikuar nga INSTAT. Ky target është i aplikueshëm për periudhën 2009-2011.

Përderisa nuk ka tregues tjetër të disponueshëm dhe tendenca afatgjatë tregon kapacitetin e Bankës së Shqipërisë për të ruajtur targetin e inflacionit, ne parashikojmë se Banka e Shqipërisë do të ruajë targetin e inflacionit edhe për periudhat e ardhshme. Për rrjedhojë, ne mendojmë se norma e inflacionit për të gjithë periudhën 2012 – 2014 do të jetë 3.0 %.

4. Kursi i shkëmbimit valutor

Norma mesatare e shkëmbimit valutor të Euros kundrejt lekut për gjysmën e parë të vitit 2011 ka qenë 140,63 EUR/lekë, duke iu referuar publikimeve zyrtare të Bankës së Shqipërisë (www.bankofalbania.org). Norma e zhvillimit pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm (burimi i të dhënave: www.bankofalbania.org/web/Exchange_Rates_2014_2.php).



Parashikimi i Raiffeisen Bank Albania jepet në grafik dhe tregon kursin mesatar të shkëmbimit valutor për gjysmën e dytë të vitit 2011 në 141,30 EUR/ALL dhe 140,75 EUR/ALL përkatësisht për vitin 2012.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Për më tepër, ne kemi marrë vlerësime nga Raiffeisen bank Albania për sa i përket zhvillimi të normës së shkëmbimit valutor për dollarin amerikan përkundrejt lekut.

Për konvertimet e valutave të tjera (të përdorura në llogaritjen e WACC për konvertimin e huave të ndryshme), ne kemi përdorur të dhëna të Departamentin të Thesarit të CEZ a.s, duke u bazuar në situatën aktuale në terren dhe te tregjeve.

Duke u bazuar në sa më sipër, ne kemi perlllogaritur kurset e shkëmbimit valuator përkundrejt Lekut, siç tregohet ne tabelën e mëposhtme.

Quarterly forecasts (eop)	2011			2012			
	VI.11	IX.11	XII.11	III.12	VI.12	IX.12	XII.12
	Q2 2011	Q3 2011	Q4 2011	Q1 2012	Q2 2012	Q3 2012	Q4 2012
EUR/ALL (eop)	141,20	140,50	142,10	142,00	140,00	141,00	140,00
USD/ALL (eop)	96,05	93,67	98,00	101,43	107,69	112,80	112,00
JPY/USD	76,50	76,60	76,60	76,60	76,60	76,40	76,20
KRW/USD	1076,40	1122,00	1247,00	1100,00	1090,00	1100,00	1110,00
SDR/EUR	1,12	1,12	1,12	1,12	1,12	1,12	1,12
JPY/ALL	1,26	1,22	1,28	1,32	1,41	1,48	1,47
KRW/ALL	0,09	0,08	0,08	0,09	0,10	0,10	0,10
SDR/ALL	157,72	156,94	158,73	158,61	156,38	157,50	156,38

Fig 1. FX rates and Cross-rates of Albanian LEK

Përderisa nuk kemi në dispozicion parashikime të tjera për periudha më të gjata, ne do të përdorim një mesatare dhe normat e parashikuara të këmbimit valutor në fund të periudhës për vitin 2012 edhe për perlllogaritjet paraprake të viteve 2013 – 2014, duke pasur në mendje se këto do të rillogariten sipas parashikimit aktual të disponueshëm në momentin e rishikimit të tarifave për vitet përkatëse.

5. Përcaktimi i çmimeve për FPSH dhe OST për 2012 - 2014

5.1. Çmimi i përdorur për FPSH dhe OST për periudhën 2012 - 2014

CEZ Shpërndarje pranon përgjegjësinë e ERE-s për sa i përket tarifave përkatëse të Furnizuesit Publik me Shumicë (FPSH) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe për pasojë, përdor në të gjitha perlllogaritjet e veta, vlera e miratuara për vitin 2010, d.m.th. 1 480 LEK/MWh për FPSH dhe 600 LEK/MWh për OST. Duke u bazuar në këtë, llogaritjet e tarifave të CEZ Shpërndarje për OSSH dhe FPP do të rillogariten automatikisht duke iu referuar vendimit të ERE-s në lidhje me përcaktimin e këtyre tarifave.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

6. Kërkesa për energji në lidhje me aplikimin e tarifave

6.1. Kërkesa për energji dhe numri i konsumatorëve i parashikuar për vitet 2011 dhe 2012

Në tekstin e mëposhtëm jepet përshkrimi i llogaritjes së kërkesës për energji për vitet 2011 dhe 2012. Vlerat konkrete janë dhënë në Shtojcën nr. 1. Parashikimi i kërkesës bazohet mbi nivelet e tarifave, sic tregohet në Shtojcën nr. 6. Në rast se do të ketë ndryshime domethënëse në strukturën e tarifave dhe nivelin e tarifave përkatëse, atëherë do të ketë një ndikim të konsiderueshem në kërkesën e parashikuar, si dhe mund të ndryshojnë qëndrimin e konsumatorëve dhe interesat e tyre për furnizimin. Në rast të kryerjes së të tilla ndryshimeve, kërkesa e parashikuar do të rillogaritet.

6.1.1. Metodologjia e përdorur

Me qëllim ndërtimin e parashikimit të kërkesës, u përdorën burimet e mëposhtme të informacionit të konsumit sasior:

- Historiku i të dhënave të matura të konsumit të energjise për periudhën Janar 2009- qershor 2011 për çdo segment të kategorive të konsumatorëve,
- Informacioni direkt nga konsumatorët rreth konsumit të pritshëm (e përdorur për konsumatorë të mëdhenj në TL dhe TM - shiko përshkrimin e mëposhtëm),
- konsumi i pritshëm nga konsumatorët e rinj të cilët do furnizohen nga CEZ-Shpërndarje,
- historiku dhe numri i pritshëm i konsumatorëve.

6.1.2. Konsumatorët e lidhur në rrjetin e Tensioni të Lartë (përfshirë 220kV dhe 110 kV)

Parimet e përdorura për parashikimin e kërkesës për konsumatorët në rrjetin e OST ose OSSH janë të njëjta dhe janë bazuar mbi informacionin e dhënë nga konsumatorët përkatës.

Për parashikimin e konsumit të konsumatorëve në TL është përdorur informacioni direkt nga konsumatorët, informacion i marrë nga Menaxherët e Korporatave (KAM). Bazuar në rishikimet e detajuara të ngarkesave mujore të 2010 dhe 2011, të bera me klientet individuale me të mëdhenj, pritshmeria e kërkesës së energjise të secilit klient në TL është reflektuar në parashikimin e kërkesës për 2012. Informacioni i kërkuar nga konsumatorët ishte:

- parashikimi i kërkesës për energji për H2 2011 krahasuar me H1 2011, dhe
- parashikimi i kërkesës për energji për 2012 krahasuar me gjithë vitin 2011.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

6.1.2.1. Parashikimi për konsumatorët në TL për H2 2011

Parashikimi i konsumit total (përfshirë konsumin aktiv dhe pik) të konsumatorëve në TL për muajt përkatës është realizuar bazuar mbi konsumin për H1 2011 dhe ndryshimin e pritshëm të konsumit të dhënë nga konsumatorët përkatës. Është përdorur formula e mëposhtme:

$$\left(\left(\sum_{\text{January}}^{\text{June}} T_j \right) * x\% \right) / 6 + T_j = T_i \quad (\text{A.1})$$

Energjia në pik llogaritet për muajt përkatës si më poshtë:

$$\frac{p_j}{T_j} * T_i = p_i \quad (\text{A.2})$$

Energjia aktive llogaritet për muajt përkatës si më poshtë:

$$T_i - p_i = A_i \quad (\text{A.3})$$

ku:

T konsumi total (energja aktive dhe energjia pik) për muajt përkatës

A energjia aktive për muajt përkatës

P energjia pik në muajt përkatës

i korrik – dhjetor 2011

j janar – qershor 2011

x% ndryshimi i pritshëm i konsumit për konsumator (nëpërmjet KAM) krahasuar më H1 2011

6.1.2.2. Parashikimi për konsumatorët në TL për vitin 2012

Parashikimi i konsumit total (aktive dhe pik përfshirë) të konsumatorëve në TL për muajt përkatës është realizuar bazuar mbi konsumin për H1 2011 dhe ndryshimin e pritshëm të konsumit të dhënë nga konsumatorët përkatës. Është përdorur formula e mëposhtme:

$$\left(\left(\sum_{\text{January}}^{\text{December}} T_j \right) * x\% \right) / 12 + T_j = T_i \quad (\text{A.4})$$

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Energjia në pik llogaritet për muajt përkatës si më poshtë:

$$\frac{p_j}{T_j} * T_i = p_i \quad (A.5)$$

Energjia aktive llogaritet për muajt përkatës si më poshtë:

$$T_i - p_i = A_i \quad (A.6)$$

ku:

T konsumi total(energjia aktive dhe energjia pik për muajt përkatës

A energjia aktive

P energjia pik në muajt përkatës

i Janar-Dhjetor 2012

j Janar-Dhjetor 2011

x% ndryshimi i pritshëm i konsumit për konsumator (nëpërmjet KAM) krahasuar më 2011

CEZ Shpërndarje dëshiron të theksojë që ndërmjet konsumatorëve të lidhur në rrjetin OST, ku CEZ Shpërndarje furnizon me energji është përfshirë Kurum, Antea Titan Cemet (furnizimi ka filluar në Janar 2011) dhe FKCF e cila u rilidh nga rrjeti në TM në rrjetin e TL (filloi në Shkurt 2011).

Me rrjetin e OSSH në TL (110 kV) është përfshirë Armo dhe është llogaritur gjithashtu me konsumatorin ACR (Darfo) i cili shprehu interes për furnizim si konsumator tarifor me asetet e veta të shpërndarjes nga Janari 2012.

6.1.3. Konsumatorët të lidhur në 35 kV

Duke analizuar historikun e konsumit të konsumatorëve në këtë nivel tensioni kemi evidencuar konsumatorët më të rëndësishëm (konsumatorët që përfaqësojnë më shumë se 50% të totalit të konsumit në 35 kV). Bazuar në rishikimet e detajuara të ngarkesave mujore të 2010 dhe 2011, të bëra me klientet individuale me të mëdhenj, pritshmëria e kërkesës së energjisë të klientëve në TM, të cilët përfaqësojnë 50% të volumit të energjisë, është reflektuar në parashikimin e kërkesës për 2012. Në kemi marrë në konsideratë kërkesën e tyre për parashikimin e energjisë, si bazë:

- parashikimi i kërkesës për energji për H2 2011 krahasuar me H1 2011 dhe
- parashikimi i kërkesës për energji për 2012 krahasuar mbi gjithë vitin 2011.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Procedura e llogaritjes së konsumit të parashikuar të konsumatorëve të rëndësishëm është e njëjtë me një nga konsumatorët në Tension të lartë, kështu për përllogaritjen e formulave mund ti referoheni pikës 6.1.2.

Për pjesën e “mbetur” të konsumatorëve (më pak se 50% e konsumit total në 35 kV) është përdorur krahasimi i tendencës të të dhënave historike të konsumit për çdo kategori konsumatori.

Totali i konsumit historik për çdo kategori konsumatori në 35 kV është i reduktuar për konsumin e klientëve të “rëndësishëm” (si është përshkruar më sipër), prandaj rezultati është konsumi për konsumatorët e “mbetur” të lidhur në 35 kv.

Për konsumin e “mbetur” sipas kategorive Industri, Tregti dhe Shërbime, nga analizimi i të dhënave historike, ne shohim që nuk ka trend të cilin mund ta përdornim për parashikim (rënie e konsiderueshme e konsumit nga viti në vit). Për këtë arsye për H2 2011 është parashikuar i njëjti konsum si në H1 2011 dhe i njëjti për vitin 2012. Formulatat konkrete janë:

$$T_{i2011} = T_{j2011} \quad (B.1)$$

ku:

T konsumi total i muajve përkatës

i janar - qershor 2011

j korrik – dhjetor 2011

$$T_{i2011} = T_{i2012} \quad (B.2)$$

ku:

T konsumi total i muajve përkatës

i janar – dhjetor

Llogaritja e energjisë aktive dhe energjisë në pikë është e njëjtë si në formulat përkatëse në pikën 6.2.1.

- Për konsumin e “mbetur” të kategorisë Të Tjerë, historiku i konsumit fillon nga viti 2010 deri në qershor 2011. Bazuar mbi faktin që aty kemi konsum mujor stabil (trend i qëndrueshëm) për konsumin historik, për parashikim janë përdorur formulatat e mëposhtme:

Aplikimi i tarifave 2012-2014

$$T_{i2011} / T_{i2010} = Coef_i \quad (B.3)$$

ku:

T konsumi total ne muajt përkatës

i janar - qershor

Coef koeficient i ponderuar ndermjet konsumit total ne muajin respektiv

$$\overline{(Coef)}_i * T_{j2010} + T_{j2010} = T_{j2011} \quad (B.4)$$

ku:

\overline{Coef} mesatarja e koeficientit të ponderuar për periudhën përkatëse H1 2011

i janar – qershor

j korrik – dhjetor

$$\overline{(Coef)}_{i2011} * T_{i2011} + T_{i2011} = T_{i2012} \quad (B.5)$$

ku:

$\overline{(Coef)}_{i2011}$ mesatarja e koeficientit të ponderuar për vitin 2011

i janar – dhjetor

Totali i konsumit të pritur nga çdo kategori konsumatori në 35 kv është shuma e konsumit të pritshëm nga konsumatorët e rëndësishëm dhe konsumit të “mbetur” të pritshëm i cdo kategorie konsumatori.

6.1.4. Konsumatorët e lidhur në 20/10/6 kV

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Për nivelin e tensionit 20/10/6 kV janë përdorur të njëjta parime si në nivelin e tensionit 35 kV. Kjo do të thotë që është bërë ndarja e konsumit ndërmjet konsumatoreve të rëndësishme me parashikimin e tyre të konsumit dhe konsumit të “mbetur” me trendin historik.

Për konsumatorët e rëndësishëm kemi marrë në konsideratë kërkesën e tyre për parashikimin e energjisë si bazë:

- parashikimi i kërkesës për energji për H2 2011 krahasuar me H1 2011 dhe
- parashikimi i kërkesës për energji për 2012 krahasuar mbi gjithë vitin 2011.

Procedura e llogaritjes se konsumit të parashikuar të konsumatorëve të rëndësishëm është e njëjtë me atë të konsumatorëve në Tension të lartë ose Tension të mesëm 35 kV, kështu për llogaritjen e formulave mund ti referoheni pikës 6.1.3.

Historiku i konsumatorëve të rëndësishëm është zbritur nga totali i konsumit në kategorite përkatëse. Parashikimi i konsumit të “mbetur” për çdo kategori konsumator i(Industri, Tregti dhe Shërbime, Prodhim mielli dhe Furra Buke, Bujqësi, Të tjerë, Buxhetorë), është realizuar bazuar mbi historikun e konsumit të tyre.

1. Për kategoritë: Industri, Tregti dhe Shërbime, Prodhim mielli dhe Furra Buke, Të tjerë, Buxhetorë, historiku i të dhënave nga 2009 - Qershor 2010 tregon trend të aplikueshëm; kështu që është përdorur trendi për parashikim, bazuar mbi formulat e mëposhtme:

$$T_{i2010} / T_{i2009} = Coef1_i \quad (C.1)$$

$$T_{j2011} / T_{j2010} = Coef2_j \quad (C.2)$$

ku:

T konsumi total në muajt përkatës

j janar - qershor

i korrik – dhjetor

Coef1 koeficienti i ponderuar për H2 2010 kundrejt H2 2009

Coef2 koeficienti i ponderuar për H1 2010 kundrejt H2 2009

Për parashikimin e muajve përkatës të H2 2011, ne kemi marrë më shumë në konsideratë zhvillimet e fundit të konsumit historik: H1 2011 dukë i vënë një koeficient/peshë $k_1=0.6$ dhe për H2 2010 koeficient/peshë $k_2=0.4$

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

$$(\overline{Coef2_j} * k_1 + \overline{Coef1_i} * k_2) * T_{z2010} + T_{z2010} = T_{z2011} \quad (C.3)$$

ku:

$\overline{Coef1_i}$ koeficienti i ponderuar për H2 2010 kundrejt H2 2009

$\overline{Coef2_j}$ koeficient i ponderuar për H1 2011 kundrejt H1 2010

z korrik – dhjetor

T konsumi total në muajt përkatës

Për parashikimin e konsumatorëve të sipërpërmendur për vitin 2012, përdorim formulën e mëposhtme:

$$(\overline{Coef2_j})_{2011} * T_{i2011} + T_{i2011} = T_{i2012} \quad (C.4)$$

ku:

$(\overline{Coef2_j})_{2011}$ mesatarja e koeficientit të ponderuar për vitin 2011 kundrejt 2010

j janar – dhjetor

T konsumi total në muajt përkatës

2. Për kategorinë Bujqësi, bazuar mbi faktin që historiku i të dhënave nuk ka trend (rënie të konsiderueshme të konsumit vit pas viti), ne kemi përdorur formulat e mëposhtme:

$$T_{i2011} = T_{j2011} \quad (C.5)$$

ku:

T konsumi total në muajt përkatës

i janar - qershor 2011

j korrik – dhjetor 2011

Aplikimi i tarifave 2012-2014

$$T_{i2011} = T_{i2012} \quad (C.6)$$

ku:

T konsumi total në muajt përkatës
 i janar – dhjetor

Llogaritja e energjisë aktive në pik dhe energjisë aktive është e njëjtë si në formulat respektive (A.5) dhe (A.6) .

Totali i pritshëm i konsumit për çdo kategori konsumatori është shuma e konsumit të pritshëm nga konsumatorët e rëndësishëm dhe konsumit të pritshëm cdo kategorie konsumatori.

Ne konsumin e pritshem 2012 jane perfshire 2 konsumatore te rinj me konsum sinjifikativ. Nje ne kategorie Industri (konsumi i pritshem 32 GWh) dhe i dyti ne kategorie Tregti dhe Sherbime (konsumi i pritshem 25 GWh).

CEZ Shperndarje gjithashtu pret nje rritje natyrale te konsumatoreve te lidhur ne rrjetin 20/10/0 kv. CEZ shperndarje pret 200 konsumatore te rinj te lidhur gjate H2 2011 dhe 400 pergjate vitit 2012.

6.1.5 Konsumatorët tregtare në nivel tensioni 0.4 kV(perjashtuar familjarët)

Për konsumatorët jo-familjarë lidhur në tension 0.4kv, është përdorur lidhja midis historikut të konsumit dhe zhvillimit të PPB -së. Ne kemi supozuar korelacion te ngushtë ndërmjet GDP-së dhe konsumit të biznesit ne nivelin e TU.

Zhvillimi i konsumit historik tregon, që numri i konsumatorëve është i lidhur me rritjen e GDP, por mesatarja e konsumit për klient është në rënie - shiko grafikun.

Për parashikim, është përdorur konsumi mesatar i pritshëm , bazuar mbi funksionin “LOGARITMUS trend” dhe numrin e pritshëm të konsumatorëve.

LOG trend është përdorur me pritshmërinë që konsumi mesatar për konsumator do të ketë një limit më të ulët dhe do të presim stabilizim të konsumit mesatar.

Analiza është bërë mbi bazën e të dhënave tre mujore, sepse të dhënat e disponueshme për PBB janë në bazë tre mujore.



Hapat e parashikimit:

Duke pasur të dhënat historike mujore për gjithë kategoritë e konsumatorëve lidhur në tension të ulët nga 2009 deri Qershor 2011, ne llogaritëm konsumin mesatar për çdo muaj përkatës të konsumatorëve.

Historiku i të dhënave të konsumit për perudhën 2009 deri më H1 2011, numri i konsumatorëve dhe konsumi mesatar mujor për çdo konsumator është i ndarë në tremujore përkatëse të vitit respektiv, duke përdorur formulat e mëposhtme:

$$Q_{consumption_i} = \sum M_j \tag{D.1}$$

ku:

M konsumi mujor për tre mujorin përkatës

i tre mujori përkatës për vitin përkatës

j muaji përkatës

$$Q_{customers_i} = \overline{Co.M_j} \tag{D.2}$$

Aplikimi i tarifave 2012-2014

ku:

$\overline{C o . M }_i$ mesatarja e numrit të konsumatorëve për tre mujorin përkatës

i tre mujori përkatës për vitin përkatës

$$Q_{averageconsumption}_i = \sum_{j=1}^3 \overline{M}_j \quad (D.3)$$

ku:

\overline{M} mesatarja e numrit të konsumatorëve për tre mujorin përkatës

i tre mujori përkatës për vitin përkatës

Për PBB ne kemi përdorur raportin zyrtar nga Instat (Produkti I Brendshëm Bruto tre mujor - publikuar në tre mujorin e parë të 2011) - PBB me cmimet bazë – janë përdorur vlerat me sezonalitet të axhustuar.

Duke marrë në konsideratë PBB, që në 2009 deri në H1 2011, ne analizuar se si këto tre variabla (konsumi mesatar i tre mujorit, numri mesatar i konsumatorëve i tre mujorit dhe ndryshimi i PBB në tre mujore) kanë influencuar tek njëri tjetri, në mënyrë që të realizohet parashikimi i ketyre kategorive.

Rezultatet nga analizat është gjithashtu treguar në grafikun më sipër.

Për parashikimin e H2 2011 dhe 2012 ne kemi përdorur numrin e pritshëm të konsumatorëve, mbi bazën e të dhënave historike të lidhjeve të reja në konsumatorët jofamiljarë në tension të ulët siguruar nga divizioni i shpërndarjes. Ne presim 2 700 lidhje të reja për H2 2011 dhe 5 400 për vitin 2012.

Pas me formulën matematike “Loglinternd” ne llogaritëm konsumin mesatar për tre mujorët Q3, Q4 2011 dhe vitin 2012 (duke marrë në konsideratë zhvillimin e konsumit mesatar për 10 tremujorët e fundit).

Konsumi mesatar për tre-mujorët shumëzuar me numrin e pritshëm të konsumatorëve, na jep konsumin total të pritshëm për tre-mujorët përkatës të konsumatorëve jofamiljarë në tension të ulët.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

Për ndarjen e konsumit total për H2 2011 dhe vitin 2012 ndërmejt kategorisë të konsumatorëve përkatës, është përdorur koeficienti i ponderuar historik të konsumit për cdo kategori konsumatori të H1 2011 kundrejt konsumit total të H1 2011.

CEZ shpërndarje thekson se ne jemi në procesin të instalimit të matësve “Converge” në tension të ulët për klientët e mëdhenj. Plani ynë është të kemi të instaluara afërsisht 1 100 matësve converge në tension të ulët deri në fund të vitit 2012. Në lidhje me instalimin e matësve converge, ne do të dëshironim të paraqesim tarifën e energjise pik për konsumatorët jofamiljarë në tension të ulët. Në lidhje me këtë ide ne kemi bërë vlerësimin e konsumit të pritshëm, që mund të konsumohet në orët e pikut në tension të ulët.

Vlerësim ekspert është bërë mbi bazën e konsumit historik të 1 100 konsumatorë të rëndësishëm për periudhën 07/2010 – 06/2011. Ky konsum është afërsisht 214 GWh. Sipas vëzhgimit historik, raporti ndermjet energjise aktive në pik dhe energjisë aktive është rreth 15%. Për faktin se ne do të vazhdojmë me instalimin e matësve converge gjithashtu gjatë vitit 2012, ne supozojmë një faktor utilizimi 60% te kohes totale. Së fundi konsumi i pritshëm në tarifën pik në tension të ulët është:

$$214 * 0,15 * 0,6 = 19 \text{ GWh.}$$

Ndarja ndërmjet kategorive të konsumatorëve është bërë mbi bazën e konsumit total të pritshëm në cdo kategori për vitin 2012 përkundrejt konsumit total në jofamiljarët në tension të ulët.

6.1.6 Konsumatorët familjarë

Për konsumatorët familjarë, temperaturat luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen ose uljen e konsumit të tij, kështu duke marrë parasysh këtë fakt, ne përdorëm faktorin temperaturë/metodën e temperaturës. Ne përdorëm metodologjinë e krijuar nga Kevin Baumert dhe Mindy Selman te quajtur “Shkalla e ditëve për ngrohje dhe ftohje” (“Heating and Cooling Degree Days”).

Parimi bazë i metodologjisë është llogaritja e:

HDD heating degree days = sa “shkallë” kemi nevojë për ngrohje

CDD cooling degree days = sa “shkallë” kemi nevojë për ftohje

Përshkrimi i metodologjisë është bashkangjitur në Shtojcën nr. 2.

Pas konvertimit të temperaturave historike mujore nga 2008 deri më 2010, të mara nga MeteoAlb për 17 qytete të Shqipërisë (B. Curri, Berat, Durres, Elbasan, Erseke, Fier, Gjirokaster, Korce, Kukes, Lezhe, Poshkopi, Pogradec, Puke, Sarande, Shkoder, Tirane, Vlore) në “shkallë” për secilën indeks për ngrohje ose ftohje; këto indekse u përdorën për parashikimn e konsumit.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Parashikimi për familjarët u bë duke në konsideratë konsumin e të dy blloqeve të ndarë, në bllokun e parë më të vogël/baraz se 300 KWh dhe në bllokun e dytë mbi 300 KWh .

Hapat e veprimeve në arritjen e parashikimit:

- 1- Llogaritja e koeficientëve HDD & CDD duke përshtatur metodologjinë për gjithë Shqipërinë.
- 2- Llogaritëm konsumin mesatar për një konsumator në secilin bllok për cdo muaj përkatës duke u bazuar te formula:

$$\frac{k_{\leq 300(j)}}{n_{\leq 300(j)}} = k.m_{\leq 300(j)} \quad , \quad \frac{k_{>300(j)}}{n_{>300(j)}} = k.m_{>300(j)} \quad (E.1)$$

- 3- Llogarisimin konsumin mesatar për një konsumator në secilin bllok për DD në muajt përkatës.

$$\frac{k.m_{\leq 300(j)}}{N_{DD(j)}} = k1_{ij} \quad , \quad \frac{k.m_{>300(j)}}{N_{DD(j)}} = k2_{ij} \quad (E.2)$$

- 4- Llogarisim HDD & CDD për një vit, duke marrë në konsideratë mesataren e tyre në muajt përkatës (HDD&CDD Normative vjetore):

$$\overline{DD_{ij}} = DD_j \quad (E.5)$$

- 5- logarisim konsumin e pritshëm për një klient për DD

Blloku i parë

$$DD_j * \overline{k1_{ij}} = k.m1_j \quad (E.6)$$

Blloku i dytë:

$$DD_j * \overline{k2_{ij}} = k.m2_j \quad (E.7)$$

ku:

$k_{\leq 300}$, $k_{>300}$ konsumi në bllokun përkatës

$n_{\leq 300}$ $n_{>300}$	numri i konsumatorëve në bllokun përkatës
$k.m_{\leq 300}$ $k.m_{>300}$	konsumi mesatar për klient në bllokun përkatës
$k1$ $k2$	konsumi mesatar për konsumatorin për DD në bllokun përkatës
DD	HDD&CDD në një muaj të caktuar
N_{DD}	numri i DD
\overline{DD}	mesatarja e shkallës mujore (viti normativ)
$\overline{k1}_{ij}$ $\overline{k2}_{ij}$	konsumin mesatar për një konsumator në secilin bllok për DD
$k.m1$	konsumi mesatar i pritshëm për konsumator në bllokun e parë
$k.m2$	konsumi mesatar i pritshëm për konsumator në bllokun e dytë
j	muajt përkatës të vitit
i	vitet përkatëse {2009,2010,2011}

6- Numri i pritshëm i konsumatorëve familjar është bazuar në historikun e të dhënave për lidhjet e reja, të dhëna të siguruar nga divizioni i shpërndarjes. Ne presim të lidhen 5 000 konsumatorë familjarë të rinj për H2 2011 dhe 10 000 konsumatorë familjarë të rinj për 2012.

Parashikimi i numrit të konsumatorëve për secilin muaj u realizua duke u bazuar në trendin historik të ndryshimeve mujore të konsumatorëve (duke respektuar gjithashtu lëvizjen ndërmjet bllokut të parë e të dytë të familjarëve) sipas formulave të mëposhtme.

7- Parashikimi i familjarëve për muajt e H2 2011:

Blloku i parë:

$$T_{j-1} + (Nr/6) * (\overline{N1/T})_{ij} = n.B1_j \quad (E.8)$$

Blloku i dytë:

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

$$T_{j-1} + (Nr/6) * (\overline{N2/T})_{ij} = n.B2_j \quad (E.9)$$

ku:

T numri total i konsumatorëve

Nr numri i konsumatorëve të rinj

$\overline{N1/T}$ mesatarja e % që zë nr. i konsumatorëve në blloku e parë përkundrejt nr. total të konsumatorëve

$\overline{N2/T}$ mesatarja e % që zë nr. i konsumatorëve në blloku e dytë përkundrejt nr. total të konsumatorëve

n.B1 numri i konsumatorëve të parashikuar në bllokun e parë

n.B2 numri i konsumatorëve të parashikuar në bllokun e dytë

j muaji përkatës që i referohemi për parashikim

j-1 muaji i mëparshëm i j

i viti {2009,2010,2011}

8- Parashikimi i numrit të konsumatoreve familjarë për muajt e vitit 2012

Numri i parashikuar të konsumatorëve familjarë për çdo muaj të vitit është bere sipas një perlllogaritjeje të njëjtë si për H2 2011.

$$T_{j-1} + (Nr/12) * (\overline{N1/T})_{ij} = n.B1_j \quad (E.10)$$

$$T_{j-1} + (Nr/12) * (\overline{N2/T})_{ij} = n.B2_j \quad (E.11)$$

Aplikimi i tarifave 2012-2014

9- Parashikimi i konsumit të familjarëve për H2 2011

Parashikimi i konsumit të familjarëve për bllokun e parë:

$$n.B1_j * k.m1_j = k1_j \quad (E.12)$$

ku:

n.B1 numri i konsumatorëve të parashikuar në bllokun e parë

k.m1 konsumi mesatar i pritshëm për konsumator në bllokun e parë

k1 konsumi i parashikuar për bllokun e parë

j korrik - dhjetor

Parashikimi i konsumit të familjarëve për bllokun e dytë:

$$n.B2_j * k.m2_j = k2_j \quad (E.13)$$

ku:

n.B2 numri i konsumatorëve të parashikuar në bllokun e dytë

k.m2 konsumi mesatar i pritshëm për konsumator në bllokun e dytë

k2 konsumi i parashikuar për bllokun e dytë

j korrik - dhjetor

10- Parashikimi i konsumit të familjarëve për vitin 2012

Parashikimi i konsumit të familjarëve për bllokun e parë:

$$n.B1_j * k.m1_j = k1_j \quad (E.14)$$

ku:

n.B1 numri i konsumatorëve të parashikuar në bllokun e parë

k.m1 konsumi mesatar i pritshëm për konsumator në bllokun e parë

k1 konsumi i parashikuar për bllokun e parë

Aplikimi i tarifave 2012-2014

j janar - dhjetor

Parashikimi i konsumit të familjarëve për bllokun e dytë

$$n.B2_j * k.m2_j = k2_j \quad (E.15)$$

ku:

$n.B2$ konsumi mesatar i pritshëm për konsumator në bllokun e dytë

$k.m2$ numri i konsumatorëve të parashikuar në bllokun e dytë

$k2$ konsumi i parashikuar për bllokun e dytë

j janar - dhjetor

6.1.7 Dëmi ekonomik në tensionin e ulët

Gjithë konsumi i llogaritur më sipër për konsumatorët jofamiljarë në tension të ulët dhe familjarët në tension të ulët janë llogaritur mbi bazën e të dhënave të pastruara, pa konsumin e dëmit ekonomik. Me këtë trajtim ne respektojmë trendin natyral të konsumit. Në fund, vlerave të llogaritura u shtohen dëmet ekonomike reale për H1 2011 në kategorinë konkrete të konsumatorëve dhe vlerës së pritshme së konsumit të dëmeve ekonomike për H2 2011 dhe 2012.

CEZ Shpërndarje parashikon një dëm ekonomik në nivelin e 250 GWh për H2 2011 dhe në nivelin e 400 GWh për vitin 2012.

Këto nivele janë ndarë ndërmjet konsumatorëve familjarë dhe jofamiljarëve në tension të ulët mbi bazën e historikut të dëmit ekonomik.

Për H2 2011 – per konsumatorët jofamiljarë në tension të ulët është shtuar 76,014 GWh dhe per familjarët jane shtuar 173,986 GWh.

Për vitin 2012- per konsumatorët jofamiljarë në tension të ulët është shtuar 121,622 GWh dhe per familjarët jane shtuar 278,378 GWh.

6.2 Parashikimi i kërkesës për energji për vitet 2013 dhe 2014

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

CEZ Shpërndarje ka përdorur nivelin e rritjes prej 3.5% për vitet 2013 dhe 2014 në lidhje me parashikimin e rritjes PBB-së të Fondit Monetar Ndërkombëtar (www.imf.org).

6.3. Humbjet dhe çmimi i energjisë së importuar për periudhën 2012 – 2014

6.3.1. Çmimi i energjisë së importuar

CEZ Shpërndarje dëshiron të theksojë se në Shqipëria është një treg i shitjes me shumicë që mund të konsiderohet si "përcaktues i çmimit". Nga kjo pikëpamje, ne duhet të përdorim tregun më të afërt të shitjes me shumicë, nga ku energjia elektrike për Shqipërinë është blerë ose tregtuar, që është çmimi i diktuar për blerjen në Shqipëri.

Tregje tipike të shitjes me shumicë për Shqipërinë janë në Hungari, Bosnjë dhe Hercegovinë apo Serbia, por çmimet e këtyre tregjeve lidhen drejtpërdrejt me tregun gjerman.

Bazuar në te, mund të themi se tregjet e shitjes me shumicë nga ku duhet të ndikohet Shqipëria për përcaktimin e çmimit janë tregjet në Gjermani dhe Hungari.

CEZ Shpërndarje dhe CEZ Trade vëzhgojnë nga afër korelacionin e çmimeve në Shqipëri, Gjermani dhe Hungari në një perspektivë afatgjatë dhe nëpërmjet produkteve të tenderuara.

Për shembull, në tabelën e mëposhtme tregohet krahasimi i çmimeve për të cilat është konkluduar (duke përfshirë kapacitetet CBC) me produkte të njëjta të tregut në Hungari dhe Gjermani.

Data e tregtimit/data e ofertës ndaj CEZ Shpërndarje	Produkti	EEX		CEZ Shp		
		rënia dakord për çmimin	PXE HU rënia dakord për çmimin	Çmimi i kontratës	CEZ-EEX diferenca	CEZ-PXE diferenca
22.9.2010	cal 11 BL	49,35	49,05	49,75	0,4	0,7
22.12.2010	Jan 11 BL	56	52,6	48,77	-7,23	-3,83
21.1.2011	Feb 11 BL	52,03	49,5	49,45	-2,58	-0,05
24.2.2011	Mar 11 BL	51,56	50,35	51,69	0,13	1,34

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

24.2.2011	Apr 11 BL	49,26	48,5	49,85	0,59	1,35
28.2.2011	Apr 11 BL	49,29	48,45	50,58	1,29	2,13
18.4.2011	May 11 BL	57,2	55,35	57,27	0,07	1,92
25.5.2011	Jun 11 BL	55,6	55,75	57,24	1,64	1,49

Fig 3. Krahasimi i çmimeve të energjise elektrike

Pritshmëritë e çmimit aktual nga tregje të rëndësishme të shitjes me shumicë për “bazën vjetore të ngarkesës” për tre vitet e ardhshme:

EUR/MWh	DE	HU
2012	58	58.70
2013	58.50	59.80
2014	59	60.70

Fig 4. Parashikimi i çmimeve Baseload

Bazuar ne konturin historik te treguar ne grafikun 3 dhe bazuar ne çmimet e pritshme te tregjeve relevante, CEZ Shpërndarje ka përdorur për llogaritje çmimin e energjisë në nivelin prej 58,5 EUR/MWh pa kapacitetin ndërkufitar – CBC për te gjithë periudhën 3-vjeçare. Në të njëjtën kohë, vazhdon diskutimi rreth alokimit të ardhshëm të kapaciteteve ndërkufitare (CBC) falas. Rezultati i ketij diskutimi mund te perfshije ne menyre sinjifikative çmimin final te negocuar te energjise elektrike per mbulimin e humbjeve.

CEZ Shpërndarje do të organizojë në vjeshtë një tender për energjinë për të mbuluar humbjet e vitit 2012. CEZ Shpërndarje do t’i dorëzojë ERE-s çmimin e përditësuar të energjisë duke u bazuar në rezultatet e tenderit dhe situatën e CBC gjatë vjeshtës.

6.3.2. Programimi i humbjeve

Duke u bazuar ne studimin e humbjeve të përgatitur nga PWC dhe ne situatën aktuale të Kompanisë se Shpërndarjes për sa i përket mundësisë për të kryer investime gjatë vitit 2011, CEZ Shpërndarje do të dëshironte të propozonte një skedule të ndryshme të reduktimit të humbjeve.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

Arsyet për propozimin e një skedules së modifikuar të uljeve të humbjeve janë:

- marrja më e vonshme e OSSH (targeti fillestar për reduktim të humbjeve është negociuar duke u bazuar në marrjen e kompanisë në janar 2009, gjë që në fakt ka ndodhur në qershor 2009);
- natyra e ndryshme e investimeve në vitin 2010 për shkak të marrjes së detyrueshëm të aseteve të KESH dhe OST (kryesisht nënstacione), gjë që nuk kontribuon në uljen e humbjeve, por ka efekt të kundërt;
- Mungesa e huave afatgjatë për investime në 2010 - 2011 për shkak të mungesës së deklaratës nga institucionet shqiptare, gjë që kërkohet nga bankat dhe ka sjellë pamundësinë e përmbushjes së planit të investimeve.

Veçanërisht, mungesa e kredisë së investimeve përgjatë viteve 2010 – 2011 ka pasur një impakt domethënës në luftën efektive kundër vjedhjeve. Investimet në rrjet, linjat e izoluar dhe rindërtimi i pikave të lidhjes janë kushte thelbësore për të arritur uljen e humbjeve, jo vetëm atyre teknike, por kryesisht edhe atyre jo-teknike. Të gjitha arsyet e lartpërmendura nuk parashikoheshin në fazën e blerjes, kur programimi i reduktimit të humbjeve fillestare u negocia, dhe kanë pasur një ndikim domethënës për arritjen e uljes së targetuar të humbjeve. Është e pamundur të ulen humbjet jo-teknike pa parandalimin e rilidhjeve të paligjshme të abuzuesve në rrjet. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet investimeve masive në rrjet.

Përveç fakteve të përmendura më sipër, CEZ Shpërndarje është e vendosur të reduktojë humbjet sa më shumë të jete e mundur. Megjithatë, skedula origjinale e reduktimit të humbjeve nuk është e arritshme (sic është thënë dhe nga dy studimet e pavarura). Me një program investimi shumë ambicioz për tre vitet e ardhshme – shih kapitullin 8.2), në mënyrë realiste, mund të arrihet reduktimi i mëposhtëm i humbjeve.

2012 – minus 2%

2013 – minus 2%

2014 – minus 3%

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

7. SHPENZIMET OPERATIVE (OPEX)

7.1. Përmbledhja e aktiviteteve të mëparshme

7.1.1. Aktivitetet e kryera në Administrimin e Përgjithshëm

Gjatë dy viteve të fundit të punës në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë Shqiptare, CEZ Shpërndarje ka investuar mbi 40 milion euro në rrjetin e shpërndarjes kryesisht në matje, nënstacione dhe projekte për reduktimin e humbjeve si p.sh. në linjat ABC. Privatizimi i kompanisë ndodhi në një fazë kur rrjeti pjesën më të madhe të tij e kishte të vjetruar, joautomatike, nuk kishte teknologjinë për leximin e matësve, nuk kishte shërbimet e kujdesit të klientëve dhe një kulturë e ulët për kryerjen e pagesave të faturave. Duke u bazuar në nevojat më të domosdoshme, u përcaktuan qëllimet kryesore për përmirësimin e linjave të transmetimit, instalimin e matësve të munguar, përmirësimin e leximit të matësit, përmirësimin e shërbimeve të klientëve dhe në përmirësimin e edukimit të njerëzve për të paguar konsumin e energjisë elektrike.

Pikat e më poshtme pasqyrojnë ndryshimet kryesore që CEZ ka bërë në OSSH në Shqipëri vetëm për dy vitet e para të pranisë së tij.

7.1.2. Aktivitetet në Divizionin e Shitjeve

Në vitin 2010, Divizioni i Shitjeve u riorganizua tërësisht, duke u bazuar në praktikën më të mirë të kompanive Europiane dhe në konceptin e orientimit të efikasitetit të proceseve. Divizioni i Shitjeve është i ndarë në pesë departamente kryesore që janë: Departamenti i Arkëtimit, Koorporata e Shitjeve, Faturimi, Planifikimi i Energjisë dhe Suporti i Shitjeve.

Qendrat për Kujdesin ndaj Klientit

Në momentin e privatizimit të kompanisë nuk kishte qendra të kujdesit ndaj klientit të OSSH në Shqipëri.

Aktualisht, CEZ Shpërndarje ka 43 Qendra për Kujdesin ndaj Klientit në të gjithë vendin. Këto qendra janë një reflektim i filozofisë së re të orientuar nga konsumatori, të cilën CEZ Shpërndarje e ka paraqitur për herë të parë në kompani që nga tetori i vitit 2010. Koncepti është të krijojë një pikë takimi për klientët për të gjitha ankesat dhe pretendimet e tyre të pazgjidhura. Investimet për

krijimin e Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit përfshijnë infrastrukturën e nevojshme, krijimin dhe funksionimin e një sistemi online, e cila lidh në kohë reale Qendrat e KK me Qendrën e Faturimit, si dhe përfshijnë gjithashtu trajnimin e stafit me proceset dhe procedurat e reja dhe me kulturën e re të punës.

Më shumë se 450 punonjës janë trajnuar në lidhje me aftësitë e komunikimit, zgjidhjen e problemeve, menaxhimin e proceseve për kujdesin ndaj klientëve, etj.

Në qendrat e kujdesit ndaj klientëve, Klientët mund të paguajnë dhe të ankimojnë faturën, mund të informohen në lidhje me problemet që i shqetësojnë, mund të paraqesin kërkesat dhe të marrin shpjegime për problemet e tyre. Klientët mund të paraqesin gjithashtu kërkesat e tyre me anë të adresës së e-mailit, kujdesiabonentit@cez.al, ose nëpërmjet telefonit në numrin 0808181.

Fatura-elektronike (e-bill).

Në përputhje me filozofinë për ti shërbyer sa më mirë Klientëve, CEZ Shpërndarje në vitin 2011 ofroi shërbimin e ri të quajtur e-bill. Ky shërbim i ofron mundësinë klientëve të futen on line dhe të shikojnë faturat e tyre, siç janë faturat aktuale por edhe ato të mëparshme. Klientët mund ti shkarkojnë dhe ti printojnë faturat e tyre.

Marrja e reagimeve nga Klientët.

Gjatë vitit 2010, CEZ Shpërndarje ka bërë disa kërkime që na sigurojnë reagime të nevojshme, në mënyrë që ne të kuptojmë më mirë nevojat, perceptimin dhe shqetësimet e klientëve tanë. Ky studim për kërkime bëhet çdo tre muaj për të marrë reagimet e klientëve të saj. Rezultatet e studimeve janë përdorur për të rregulluar dhe përmirësuar proceset që çojnë në arritjen e kënaqësisë dhe përmbushjes së kërkesave të klientëve.

Centralizimi i Sistemit të Faturimit.

Rregullimi i Sistemit të Faturimit u identifikua që në fillim si një nga detyrat më të rëndësishme për t'u përfunduar. Më përpara, sistemi ishte i decentralizuar, i vështirë për tu kontrolluar dhe për të ruajtur nivelet e saktësisë. Në vitin 2010, CEZ Shpërndarje inauguroi Qendrën e Faturimit, e cila është qendra e centralizuar që operon të gjitha të dhënat e faturimit, të më shumë se 1 milion klientëve. Me

aplikimet e reja ka pasur disa përmirësime të sistemit, të cilat synojnë të përmirësojnë saktësinë dhe të minimizojnë gabimet.

Rritja e Arkëtimeve.

Një nga prioritetet kryesore të CEZ Shpërndarje është rritja e niveleve të arkëtimeve. Kompania ka përgatitur një metodë transparente dhe efikase me qëllim rritjen e nivelit të pagesave të faturave. Nëpërmjet bashkëpunimit me Postën Shqiptare dhe me Bankat kryesore në vend, për të përfunduar proceset e të dhënave, aktualisht, CEZ Shpërndarje ofron për klientët disa mënyra për të kryer pagesën e faturave. Përveç mundësisë për të kryer pagesën e faturave në të gjitha qendrat e kujdesit ndaj klientëve, klientët mund të paguajnë faturat në të gjitha degët e Postës Shqiptare ose tek degët e Bankave, të cilët mund të përdorin debi direkte ose e-banking.

Në përputhje me vlerat tona të transparencës, të gjithë ata klientë që rezultojnë si debitorë në sistemin tonë, informohen nëpërmjet mënyrave të ndryshme në lidhje me borxhin e tyre. Për të kryer këtë shërbim, klientët njoftohen rregullisht për nivelin e tyre të borxhit në faturë dhe iu dërgohen njoftime apo letra paralajmërimi për borxhet. Qëllimi nuk është për ti shkëputur energjinë Klientëve pa njoftimin dhe pa paralajmërimin e përshtatshëm, por qëllimi është të njoftohen Klientët dhe ti ofrohen mundësi të paguajnë borxhet e tyre direkt ose nëpërmjet kësteve.

Fatura dhe dërgimi i saj.

Në vitin 2010, CEZ Shpërndarje ndryshoi paraqitjen dhe strukturën e faturës dhe e bëri më të lehtë dhe më të kuptueshme për Klientët për ta lexuar. Paraqitja e re e faturës përcakton linjat e konsumit për klientët.

Elementi tjetër i ri i paraqitur me faturën e re është koncepti i fshehtësisë së të dhënave të konsumit të secilit klient. Fatura mbyllet në mënyrë të tillë që asnjë nuk mund të shohë të dhënat brenda saj. CEZ Shpërndarje ka rritur bashkëpunimin me Postën Shqiptare për të përmirësuar procesin e dërgimit të faturës si dhe ka kontraktuar dy agjenci postare private për të dërguar fatura për një kategori të caktuar klientësh.

Klientët Korporatë.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje për herë të parë që nga krijimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ka krijuar një lidhje të re bashkëpunimi me klientët e saj korporata dhe biznese. Qëllimi kryesor i CEZ Shpërndarje sh.a është që të sigurojë shërbim cilësor për klientët e saj më të rëndësishëm. Duke ndjekur praktikat më të mira të kompanive evropiane, ne kemi krijuar një departament të posaçëm që shërben kryesisht për marrëdhëniet reciproke ndërmjet kompanisë dhe klientëve të biznesit. Nëntë Menaxherë Shitjesh janë caktuar nga kompania për të punuar vetëm me këtë kategori klientësh në të gjithë vendin. Përveç kontakteve të vazhdueshme, këto Menaxherë të Shitjes i dërgojnë kompanisë informacione në lidhje me furnizimin me energji elektrike, faturimit të tyre, etj. Në rast të kryerjes së riparimeve të planifikuara në rrjet, bizneset njoftohen shumë ditë më përpara në lidhje me orarin e ndërprerjes.

7.1.3. Aktivitetet në Divizionin e Shpërndarjes.

Në mënyrë që të transformojmë kompaninë sipas një procesi të bazuar në vitin 2010, Divizioni i Shpërndarjes u riorganizua plotësisht. Strukturat e menaxhimit u organizuan në pesë departamente kryesore, me fuqi ekzekutive dhe u ndanë në katër rajone kryesore: Qendrore, në Jugperëndim, në pjesën Juglindore dhe Veriore.

Teknologjitë për Leximin e Matësit: MyAvis dhe Converge

Ndryshe me të kaluarën, kur akoma nuk ishin pajisur me matës të gjithë klientët, në vitin 2011, CEZ Shpërndarje arriti të kryejë leximin 100% të klientëve të saj, duke përdorur teknologjinë MyAvis. Lexuesve iu është dhënë një PDA, ku ata mund të fusin direkt të dhënat e matësit dhe në rastet kur klienti ka ankesa, ata i bëjnë një fotografi matësit në mënyrë që të verifikojnë konsumin mujor të tyre. PDA është e pajisur me një modul GPS, i cili kontrollon rrugën e përditshme për çdo lexues, në mënyrë që të kontrollojnë abuzimet e lexuesit, të cilët mund të raportojnë konsumin e klientëve pa shkuar në vend për të kryer leximin.

Teknologjia Converge përdoret për klientët e mëdhenj dhe bën të mundur leximin online në kohë reale dhe një lexim më të saktë të energjisë së pikut dhe të energjisë reaktive. Më shumë se 2000 pika leximi janë instaluar tashmë në të gjithë vendin, nga të cilat 800 ndodhen në Tiranë. Hedhja e të dhënave në internet i jep mundësinë këtyre klientëve të lexojnë konsumin në çdo kohë. Monitorimi i

Aplikimi i tarifave 2012-2014

matësve është bërë nga një qendër e specializuar, e pajisur me teknologjitë e artit, e cila përdor rrjetin GPRS.

Ndërprerjet dhe njoftimi i klientëve në lidhje me këto ndërprerje.

Gjendja aktuale e rrjetit, e trashëguar nga neglizhenca dhe mungesa e investimeve në të kaluarën, e pengon kompaninë të shmangë riparimet ose defektet e planifikuara dhe të nevojshme në rrjet, për shkak të mbingarkesës apo kushteve të këqija atmosferike. Duke marrë parasysh si parim prioritar transparencën me klientët e tij, janë ofruar disa mënyra komunikimi në mënyrë që të njoftohen klientët për riparimet e planifikuara në rrjet ose ndërprerjet, si rezultat i defekteve. Njoftimet janë publikuar në gazeta të paktën 48 orë përpara dhe në stacione televizive që përdorin titra lëvizëse. Përsa i përket bizneseve dhe klientëve korporatë, informacioni iu komunikohet nëpërmjet e-mailit ose telefonatave. Në çdo rajon, qendra e disapeçerisë është në krye të detyrës 24 orë për të marrë telefonata nga klientët për ndërprerjet e energjisë elektrike dhe janë publikuar disa linja telefonike për klientët.

Krijimi i Ekipit të Humbjeve jo- teknike

Një nga çështjet më të rëndësishme në shpërndarjen e energjisë elektrike në Shqipëri janë padiskutim humbjet e të dy llojeve – humbjet teknike dhe ato jo-teknike. Ndërsa lufta me te paren është qartësisht e lidhur me investimet në rrjet dhe zëvendësimin i pajisjeve të vjetra me ato të reja, për të dytën duhet një trajtim i kombinuar. Në mënyrë që të bashkepunohet me këtë çështje, CEZ Shpërndarje krijoi një ekip të veçantë, punonjës të cilët ishin të përkushtuar për zbulimin vjedhjeve në rrjet dhe të cilët morën masa ndëshkuese kundër hajdutëve, duke filluar me heqjen e linjës të paligjshme, instalimin e matësit të siguruar dhe nëse ishte e nevojshme, deri në ndjekje të procesit gjyqësor. Duke qenë se niveli i vjedhjeve është shumë më i lartë se niveli standard Evropian, CEZ Shpërndarje caktoi për këto veprime të paligjshme, burime të konsiderueshme, duke përfshirë vizita të rregullta të trajnuesve të ZQ (Zyrave Qendrore) të Republikës Çeke, në mënyrë që të zbatojnë praktikën më të mirë, për të verifikuar jo vetëm performancën e mirë të punonjësve por edhe një sërë kontrollesh të brendshme për abuzime të mundshme.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

7.1.4. Aktivitetet në Administrimin e Përgjithshëm

Burimet Njerëzore

Gjatë verës së vitit 2010, Departamenti i Burimeve Njerëzore përfundoi strukturën e re të BNJ, e cila përfshinte tabelën e re të nivelit të pagave dhe administrimin e ri të përfitimeve të personelit Takime të vazhdueshme janë mbajtur me Sindikatat përkatëse si dhe janë nënshkruar Marrëveshje Kolektive të Punës dhe Memorandume Mirëkuptimi. Për më tepër, janë përcaktuar Aktivitete për Vlerësimin e Performancës për punonjësit dhe janë vendosur rregulla dhe rregullore të rrepta për ata punonjës, të cilët abuzojnë me kodin e sjelljes në kompani. Proceset e rekrutimit janë transparente dhe janë të publikuara në faqen tonë të internetit dhe janë përcaktuar gjithashtu planet për trajnimin e punonjësve. Programet e brendshme të trajnimit me Universitetet kanë filluar dhe janë duke u zhvilluar më tej, si dhe po zhvillohen panairë për punë për të tërhequr profesionistë të rinj që mund të bëhen mjet rekrutimi. Objektivi kryesor është që të sigurojë një ekip profesionistësh, të përkushtuar dhe me nivel të lartë arsimimi, të përshtatshëm për çdo pozicion dhe të eliminojë e praktikën mashtruese. Duke marrë parasysh faktin që numri i potencialeve për punësim është kufizuar, një proces i tillë do të vazhdojë në vitet në vijim.

Transparenca dhe Ndërgjegjësimi i Klientëve për të paguar energjinë elektrike.

Kompania, për herë të parë hapi një faqe interneti, e cila ofron informacione rreth shërbimeve, mënyrave të pagesës, çmimit të energjisë elektrike, marrjen e faturës elektronike, këshilla për kursimin e energjisë, dhe lajme në lidhje me zhvillimet e kompanisë, etj. Një makinë llogaritëse në internet ndihmon klientët të llogarisin ose të vlerësojnë vetë konsumin e tyre të energjisë elektrike. Kompania, për ndërgjegjësimin e klientëve që nuk paguajnë energjinë elektrike, për të ndryshuar zakonet e tyre, ka organizuar disa fushata mediatike, duke përsëritur mesazhe të tilla si "energjinë elektrike është një produkt që duhet të paguhet si çdo produkt tjetër" ose "CEZ Shpërndarje sjell jetë në shtëpitë tuaja". Fletëpalosje, broshura dhe postera janë vendosur në të gjitha qendrat tona të kujdesit ndaj klientëve, duke i informuar ata në lidhje me aspekte të ndryshme të furnizimit me energji elektrike. Po zbatohet një praktikë e re me mediat, në mënyrë që të rritet transparenca dhe ti sigurohet publikut sa më shumë informacion që të jetë e mundur.

Infrastruktura e IT.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

Infrastruktura e IT në kompani ka pas qene e njëjtë me atë të rrjetit të shpërndarjes, pra është treguar neglizhencë për të kryer investime. Ne kemi filluar të krijojmë Rrjetet Lokale dhe Wide Area Network (LAN dhe WAN), të pajisim punonjësit me kompjuterë personalë, me qëllim ndarjen e informacionit on-line, akses në pajisjet e Kompanisë, duke përfshirë të dhënat e faturimit për stafin e përshtatshëm, informacione në lidhje me gjendjen e lidhjeve të reja etj. Kjo përfshin gjithashtu edhe licenca përkatëse, që janë blerë nga kompanitë përkatëse softwarike, duke përfshirë mjete të duhura për inxhinierët elektrikë për projektimin e rrjetit.

7.2. Ristrukturimi i organizimit të kompanisë dhe koncepti i Shërbimeve të Përbashkëta

7.2.1. Organizimi i kompanisë në vitin 2011

Ristrukturimi i Kompanisë vijoi në vitin 2011, ndërsa ndryshimet e organizimit të kompanisë kanë filluar që në tetor të vitit 2010. Kompania ka operuar me të njëjtën strukturë organizative për gjithë vitin 2011. Prandaj, viti 2011 është viti i parë i organizimit, i cili është plotësisht i efektshëm sipas proceseve. Skema organizative e vlefshme për vitin 2011, e cila përfshin numrin e punonjësve në departamentet përkatëse, duke filluar që nga janari i vitit 2011 është paraqitur në **Shtojcën Nr. 7**.

7.2.2. Organizimi i Kompanisë për vitet 2012 – 2014

Kompania do të operojë me të njëjtën strukturë organizative edhe për vitet 2012 - 2014. Megjithatë, përmirësimet e efikasitetit, të cilat u zhvilluan brenda vitit 2011, do të çojnë në reduktimin e stafit në fillim të vitit 2012. I vetmi ndryshim i organizimit të kompanisë në krahasim me atë të vitit 2011 do të jetë zhvendosja e Burimeve Njerëzore dhe Departamenteve të Menaxhimit të Shërbimeve tek Shërbimet e Përbashkëta, të ofruara nga CEZ Albania, siç është paraqitur tashmë edhe në ERE.

Kjo fazë përfshin gjithashtu bashkëpunimin ndërmjet subjekteve të CEZ në Shqipëri dhe një veprim i tillë do të jetë kosto neutrale për CEZ Shpërndarje sh.a. Ne e konsiderojmë riorganizimin e kompanisë parimisht të përfunduar dhe rrjedhimisht nuk kemi plane për ndryshime të mëtejshme dhe të rëndësishme për organizimin e kompanisë në vitet 2012 - 2014. Sigurisht që ne do të vazhdojmë të

Aplikimi i tarifave 2012-2014

monitorojmë efikasitetin e organizimit të kompanisë dhe mund ta rregullojmë atë kur të jetë e dobishme dhe me kosto efikase. Zgjidhje të tilla mund të jenë të brendshme dhe të jashtme në formën e palëve të treta. Tabela organizative e cila përfshin numrin e punonjësve në departamentet përkatëse, që është planifikuar të jetë e vlefshme që prej janarit të vitit 2012 është paraqitur në **Shtojcën Nr. 7**

7.3. Shpenzimet Personale

7.3.1. Parashikimi i Kostove Personale për vitin 2012

CEZ Shpërndarje në mesin e vitit 2011, bëri rishikimin e niveleve të pagave me ndryshimet e mëvonshme në nivele individuale, duke marrë parasysh kërkesën dhe rekomandimet e Sindikatave. Ne kemi provuar gjithashtu të mbledhim disa të dhëna të tregut për nivelet e pagave për pozicione të njëjta në industri. Parashikimi i Kostove Personale për vitin 2012 është bazuar në rregullimet e vlerësuara për nivelet e pagave individuale, në përputhje me rritjen e indeksit të punës të publikuar nga INSTAT, duke marrë parasysh numrin e planifikuar të punonjësve. Detaje për krahasimin e nivelit të pagave janë paraqitur në **Shtojcën Nr. 3**.

7.4. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE PËR VITET 2012 -2014

CEZ Shpërndarje synon të fillojë disa projekte të reja në vitet 2012 -2014, me qëllimin kryesor për të përmirësuar kërkesat e klientëve, cilësinë e shërbimit , verifikimet dhe dokumentet e aseteve të kompanisë, rishikimin e proceseve, grumbullimin e të dhënave të konsumit të energjisë në të gjitha nivelet e tensionit, të cilat do të shërbejnë për të bërë parashikim më të saktë të konsumit në të ardhmen, si dhe për përcaktimin e saktë të kostove ndërmjet niveleve të tensionit të ndryshëm dhe grupet e konsumatorëve. Përshkrimi i projekteve kryesore i cili ne po planifikojmë të paraqesim është paraqitur në paragrafët e më poshtëm.

7.4.1. Shpenzime të tjera operative (OPEX) – aktivitetet e reja në OSSH

Kontrolle të nevojshme dhe verifikime të matësve nga autoritetet e pavarura

Bazuar në ligjin e miratuar Nr. 10362, i datës 16.12.2010, duke filluar nga gushti i vitit 2011, CEZ Shpërndarje ka detyrimin të përdorë certifikimin e matësve nga kompania e pavarur dhe e licencuar

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

CSC. Jemi në bisedime e sipër me palën e tretë dhe ERE për qellimin dhe çmimet e këtyre shërbimeve. Megjithatë, qellimi i diskutuar aktual i aktiviteteve të planifikuara të kompanisë së licencuar është që të kryejë të gjithë verifikimet fillestare të matësve (rreth 65 mijë në vit), të shqyrtojë dhe verifikojë rastet e dyshimta, duke përfshirë ankesat e konsumatorëve (rreth 90 mijë në vit), si dhe çdo 5 vjet të kryejë verifikimin e të gjithë matësve për të kontrolluar saktësinë e tyre (rreth 200 mijë në vit). Në aplikimin tonë, ne supozojmë variantin maksimal për këto aktivitete, e cila do të thotë dërgimin e 80% të matësve nga punonjësit e CEZ Shpërndarje tek laboratorët e licencuar të kompanisë. Pjesa e mbetur do të bëhet direkt në terren nga kompania e licencuar, me ndihmën e punonjësve të CEZ.

Duke qenë se sfera e shërbimeve e kërkuar, e cila do të ofrohet nga pala e tretë, na duket tepër e gjerë dhe me përfitime të debatueshme për klientët, CEZ Shpërndarje ka propozuar disa rregullime në skemë e që mund të sjellë uljen e kostos. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin që ende janë në diskutim e sipër, ne jemi të gatshëm të bëjmë rillogaritjen e impaktit në Shpenzimet Operative të Kompanisë, bazuar në informacione të përditësuara, të cilat mund të jenë të disponueshme deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Dokumentimi dhe Regjistrimi i Aseteve të Shpërndarjes.

Menjëherë pas privatizimit të kompanisë filloi kryerja e regjistrimit të asetëve. Brenda dy viteve, ne hasëm vështirësi me listën e asetëve, mungesën e dokumenteve të duhura që verifikojnë ekzistencën e asetëve tona si dhe faktin se ne operojmë shumë asetë që janë në pronësi të investitorëve privatë.

Procesi i regjistrimit të asetëve nga Autoritetet Shqiptare është harxhim kohe. Brenda dy viteve, ne kemi qenë në gjendje të përfundojmë rreth 500 raste, të cilët janë " të thjeshtë", dhe duhet vetëm të ndryshohet emri i regjistruar i pronarëve nga KESH në CEZ Shpërndarje . Përsa i përket shumicës së asetëve, na mungojnë dokumentet bazë, sic janë kryesisht planet topografike, përputhjen e tyre me gjendjen reale, dhe zgjidhjen e mbivendosjes midis asetëve tona të blera dhe asetëve të pronarëve real. Rrjedhimisht, ne po planifikojmë të fillojmë një projekt për përgatitjen e planeve topografike dhe të gjithë dokumentet e tjera të asetëve. Ne duhet të regjistrojmë në total më shumë se 8'000 kabina, për të cilin duhet të përgatitet dokumenti i asetëve. Ne supozojmë që gjatë këtij aktiviteti të mbledhim edhe të dhëna shtesë për Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) dhe Teknik (TIS), të cilët do të përdoren në fazat e mëvonshme.

Sistemet e Informacionit Gjeografik dhe Teknik (GIS, TIS)

Ne po planifikojmë të fillojmë me implementimin e Sistemeve të Informacionit Gjeografik dhe Teknik nga fundi i periudhës aktuale rregullatore, me shtrirje më të gjerë në periudhën pasuese. Këto sisteme lejojnë operatorin e rrjetit të menaxhojë paraprakisht performancën dhe besueshmërinë, faturën e saktë, shërbimin cilësorë ndaj klientëve dhe riparimin e menjëhershëm të defekteve në rrjet. Aktualisht, ne po përballemi me vështirësi të ndryshme të aplikimeve grafike dhe jo-grafike, të cilat përshkruajnë pjesët e rrjetit në faza të ndryshme të ciklit të kohëzgjatjes së tij. Zakonisht, ky aplikim është një kombinim i hartave të përgatitura në letër, por në disa raste të tjera është edhe e skanuar.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

Një bazë të dhënash teknike është zhdukur plotësisht, të cilës i kanë mbetur vetëm disa pjesë të të dhënave në sistemin ERP. Në këtë aplikim të trashëguar nga e kaluara, dokumentimi i strukturës së rrjetit është ose i pjesshëm ose i papërputhshëm sepse të njëjtat asete të rrjetit mund të jenë ruajtur disa herë në sisteme të ndryshme me një nëngrup të karakteristikave të tyre përkatëse.

Sistemi i Kontrollit Mbikqyrës dhe i Marrjes së të Dhënave (SCADA)

Në fund të periudhës rregullatore, kemi në plan të fillojmë implementimin e pjesës së parë të sistemit SCADA (Sistemi i kontrollit mbikqyrës dhe i marrjes së të dhënave). Ne parashikojmë që të instalojmë aparatet përqendruar të të dhënave në vitin 2014 për të gjitha nënstacionet përkatëse dhe pajisje të tjera. Kjo na bën të mundur që të kemi një sasi më të madhe të dhënash për njësinë e dispacersisë të kontrollit në distancë, gjë që do të na japë mundësinë të veprojmë më shpejt për pasaktësitë elektrike dhe t'i reduktojmë rastet e këtyre pasaktësive. Sisteme të tilla do të kërkojnë shtrirjen e mëtejshme të linjave kontraktuara për transmetimin e të dhënave ndërmjet një qendre të tillë dispecerie dhe elementeve përkatës të rrjetit.

Shtrirja e projektit CONVERGE në rrjetin e tensionit të ulët

Në vitin 2012 ne kemi në plan të shtrijmë instalimin e elektromatësve të CONVERGE edhe drejt klientëve të përzgjedhur në kategorinë e tensionit të ulët. Objektivi i projektit është që të mbulojë përafërsisht 1.100 klientë të cilët kanë një konsum vjetor më të lartë se 80 MWh . Me një mbulim të tillë, ne besojmë se do të mbledhim të dhënat e mjaftueshme për t'i përdorur për një analizë dhe parashikim më të mirë të profilit të furnizimit. Shtrirja do të kërkojë zgjerim të mëtejshëm të linjave për transmetimin e të dhënave si dhe zgjerim të sistemit.

Parku i automjeteve (GPS Fleetware)

Duke qenë se kompania përdor një numër të madh makinash, qoftë të marra me qera qoftë të pronësuara, ajo ka nevojë ta zgjidhë këtë problem në mënyrë efikase. Zgjidhja ideale për një është sistemi gjurmues me bazë GPS i cili mundëson gjurmimin online. Bazuar në pozicionin aktual të makinave, operatorët mund të ndihen të lirshëm të zgjedhin grupin më të afërt të punës në rast të ndonjë defekti në rrjet në mënyrë që ta zgjidhin këtë problem sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe të reduktojnë defektet në shpërndarjen e energjisë tek klientët tanë deri në minimumin e mundshëm. Përveç kësaj, sistemi mundëson monitorimin e efektivitetit të grupeve të punës për një kohë të gjatë dhe i përdor të dhënat e mbledhura për një planifikim më të mirë të aktiviteteve të mirëmbajtjes, për furnizimin e cështjeve të logjistikë me materialet për riparime etj. E fundit, por jo me pak e rëndësishme, sistemi gjithashtu mundëson monitorimin e sjelljes së shoferëve si për shembull monitorimin e kufirit të shpejtësisë, gjë që kontribuon pozitivisht në sigurinë e punonjësve. Ne kemi në plan ta përdorim sistemin pasi është i njëjtë me filiale të tjera të CEZ dhe me historikun e dëshmuar të gjurmimit ka dhënë zgjidhje efektive dhe të pagabueshme.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

7.4.2. Shpenzime të tjera operative – aktivitete të reja në FPP

Përmirësimi i sistemit të faturimit

Gjatë vitit 2011 u implementua rregullimi i shpejtë i sistemit të faturimit, gjë që ka sjellë përmirësime të dukshme në kontrollin e përpunimit të të dhënave të matjes, përmirësime në kontrollin e parafaturimit, duke u lidhur me kanalet aktuale të pagesës, suportin e procesit të arkëtimit bazë dhe faturimin e standartit bazë të energjisë dhe funksionalitetet e regjistrit të klientëve.

Duke qenë se sistemi i faturimit nuk i përmbush standartet mesatare të tregut të energjisë, sistemi do të përmirësohet më tej gjatë viteve të ardhshme në mënyrë që të mbështesë vazhdimisht aktivitete kyce të biznesit si faturimi, arketimet dhe humbjet jo-teknike.

Detyrat kryesore të planifikuara për zhvillimin e sistemit të faturimit për vitin 2012 janë si më poshtë:

1. Riorganizim i strukturave të të dhënave aktuale
2. Ndryshimi dhe optimizimi i konceptit të faturimit
3. Kalimi në fazën tjetër të menaxhimit të të dhënave të matjes
4. Vendosja e rregullave të koordinimit automatik në librin e klientit.
5. Implementimi i konceptit të rregullit të punës
6. Implementimi i konceptit të menaxhimit të pajisjeve
7. Optimizim i proceseve të shërbimit të kujdesit ndaj klientit
8. Rregullime të procesit të arkëtimit

Kujdesi ndaj klientit

Një rrjet prej më shumë se 40 qendrash të kujdesit ndaj klientit të ndërtuara së fundmi është ndërtuar në gjysmën e parë të vitit 2011 duke mbuluar të gjitha qytetet kryesore në mbarë vendin me qëllim që t'u ofrojë klientëve të CEZ shpërndarje sh.a. shërbim më cilësor në ambiente komode. Qendrat e kujdesit ndaj klientit përfaqësojnë një pikëtakimi e përbashkët ku klientët mund të zgjidhin të gjitha kërkesat dhe ankesat e tyre. CEZ Shpërndarje sh.a. po punon vazhdimisht për përmirësim të

mëtejshëm dhe implementim të të gjitha proceseve me qëndër orientimi klientin me qëllim zgjidhjen e menjëhershme të kërkesave ose për të zgjidhur më shpejt probleme teknike më komplekse.

Një kriter bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit është përmirësimi i herëpashershëm i aftësive të drejtuara drejt konsumatorit, njohurive teknike dhe aftësive komunikative nëpërmjet trajnimeve të brendshme dhe të jashtme për të gjithë punonjësit që ndërveprojnë drejtpërdrejt me klientët.



Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së shërbimit që i ofrohet klientit është prioritet për periudhat e ardhshme. Objektivi kryesor në fushën e kujdesit ndaj klientit në vitin 2012, bashkë me sa u tha më sipër, do të jetë shtimi i call centers, shtrirja e rrjetit të arkave të disponueshme dhe përmirësimi i cilësisë dhe besueshmërisë së dërgimit të faturave mujore.

Call centre

Implementimi i call center do t'i ofrojë klientëve të CEZ Shpërndarje sh.a. një kanal të lehtë komunikimi i cili do t'u ofrojë zgjidhje që me telefonatën e parë të shërbimeve të përzgjedhura dhe do të përshpejtojë, thjeshtojë dhe lehtësojë kohën e përgjithshme për marrjen dhe zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave të klientëve.

Linja e kujdesit ndaj klientit e operuar nga call centre do të shndërrohet në përgjigje zanore interaktive e cila i mundëson klientëve të ndërveprojnë me të dhënat bazë të kompanisë nëpërmjet një telefoni. Pas kësaj, ata mund ta gjejnë vetë përgjigjen e kërkesave të tyre nëpërmjet dialogut iVR. Sistemet e iVR-së mund të përgjigjen me mesazh audio të incizuar ose një mesazh udhëzues që i tregon përdoruesve hapat e tjerë që duhet të ndjekë, ose lidhja e drejtpërdrejtë me operatorët e call centre të cilët marrin dhe ndoshta i japin një përgjigje të menjëhershme kërkesave të klientit ose i përpunojnë dhe ua transmetojnë ato kompanisë për veprime të mëtejshme.

Shërbimet e pritshme që ofrohen nga call centre do të jenë kryesisht si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm në lidhje me shërbimet, çmimet dhe kushtet teknike (pyetje të bëra me shpesh)

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

- Informacion mbi gjendjen e pagesës së klientit dhe gjendjen e bilancit, gjendjen e borxhit, gjendjen e shpërndarjes së faturave dhe gjendjen e kërkesave të përpunuara.
- Modifikime të të dhënave të kontratës së klientit (ndryshim i adresës postare, kontakte të reja etj.
- Marrja e ankesave dhe dorëzimi i tyre tek departamentet mbështetëse për zgjidhje të mëtejshme.
- Dhënia e një linje teknike
- Njoftim për ndërprerjet e planifikuara dhe punimet e mirëmbajtjes
- Promovimi i shërbimeve të kompanisë (p.sh. e-bill)
- Efektiviteti i këtyre qendrave profesionale dhe lehtësisht të aksesueshme do të plotësojë strukturën aktuale dhe rrjetin e qendrave të kujdesit ndaj klientit dhe do t'u ofrojë të gjithë klientëve komunikim më të lehtë me CEZ Shpërndarje sh.a. dhe zgjidhje më të shpejtë të kërkesave dhe ankesave të tyre. Si rrjedhojë, presim që klientët të ndihen më të kënaqur nga shërbimi ynë.

Implementimi i kanaleve të reja të pagesës

CEZ Shpërndarje aktualisht u ofron klientëve tre kanale pagese – qendrat e kujdesit ndaj klientit, zyrat postare dhe bankat. Megjithëse vendndodhja e këtyre kanaleve të pagesës mbulon të gjithë territorin e vendit, qëllimi i CEZ Shpërndarje sh.a. është t'u mundësojë klientëve të tij një rrjet më të gjerë të pikave të pagesës ku ata mund të paguajnë më lehtësisht dhe më shpejt detyrimet e tyre financiare, në orare më të zgjatura.

Kompania aktualisht është në kërkim të partnerëve nga institucionet buxhetore, jo buxhetore dhe institucione të tjera me një mbulim më të gjerë territorial vecanërisht në bashkitë më të vogla për të hapur kanale të reja pagese për transaksione me sferë të kufizuar në cerekun e fundit të vitit 2011 me një shtrirje të plotë të planifikuar në vitin 2012.

Për rrjedhojë, CEZ Shpërndarje sh.a. do të fillojë përdorimin e qendrave lëvizëse të kujdesit ndaj klientit në zonat rurale (makina me logon e kompanisë me akses online të sistemit të faturimit dhe me regjistrin fiskal etj). Kjo qendër lëvizëse e kujdesit ndaj klientit do të ofrojë shërbimet bazë si printimin e faturave, arkëtimi i borxheve dhe i pagesave, marrëveshjet e pagesave të pjesshme dhe pranimin e ankesave të klientit.

Implementimi i shtrirjes së sipërpërmendur të kanaleve të aksesueshme të pagesave lidhet pashmangshmërisht me kostot operative shtesë. Kostot operative për tarifën e paguar nëpërmjet kanaleve të pagesës, qofshin ato të reja ose Posta Shqiptare që përdoret aktualisht do të rriten edhe

Aplikimi i tarifave 2012-2014

nga volumi më i madh që pritet nga vlerat e faturuara, bazuar në kërkesë më të lartë dhe për pasojë fatura më të larta për klientët pasi tarifata bazohen në përqindjen vlerës së arkëtuar .

Dërgimi i faturave të energjisë elektrike

CEZ Shpërndarje sh.a prej kohësh po përballlet me problem të ndryshme në lidhje me dërgimin e faturave mujore të energjisë për shkak të mungesës së cilësisë nga partneri kryesor i shpërndarjes, Posta Shqiptare, pasuar nga struktura e paplotë e sistemit postar në Shqipëri. Dërgesat e gabuara ose mos dërgimi i faturave mujore ka pasoja domethënëse në informimin e konsumatorit për konsumin aktual të energjisë elektrike dhe për detyrimet financiare totale ndaj kompanisë. Mos dërgimi i faturave gjithashtu rrit ndjeshëm rrezikun e moskryerjes së pagesës nga klienti dhe ka ndikim negative në borxhet e këqija të kompanisë, gjë që është kritikuar shpeshherë si nga publiku ashtu edhe nga institucionet.

CEZ Shpërndarje sh.a., po përdor aktualisht dy partnerë të alternative për të dërguar faturat mujore për klientët dhe territoret e përcaktuara, të dy bashkë ata mbulojnë rreth 60.000 klientë.

Duke qenë se kompania është e ndërgjegjshme për rëndësinë e cilësisë së shërbimit, ajo ka në plan të shtrijë mbulimin e klientëve me operatorë alternative të dërgimit në vitin 2012 për të mbuluar 300'000 klientë shtesë. Kjo do të sjellë pashmangshmërisht kosto operative shtesë në njërin anë, por në anën tjetër kjo do të rrisë dukshëm cilësinë e dërgimit të faturës që kërkohen nga klientët tanë.

Sistemi i parashikimit të energjisë (XEnergie)

Një sistem krejtësisht i ri i parashikimit të energjisë do të implementohet për të menaxhuar më mirë detyrimet e programuara të CEZ Shpërndarje sh.a.

Funksionet e sistemit të ri do të mundësojnë menaxhimin më të mirë të profilit të të dhënave dhe do të parashikojnë konsumimin e portofolit të klientit tarifor të CEZ Shpërndarje sh.a me saktësi më të madhe duke përdorur metoda të integruara të parashikimit për parashikimet afatshkurtra të ngarkesës me energji (nga 1 – 7 ditë) dhe parashikimet afatmesme të ngarkesës me energji (nga 1 muaj deri në 1 vit). Sistemi po përdor një set të përbërë metodash statistike dhe regresioni për të gjetur, analizuar dhe parashikuar konsumin e energjisë së portofolit, bazuar në regresorë historikë dhe të pritsëm si data, temperatura, ekspozimi, stina e vitit, ditët e punës, pushimet zyrtare etj.

Implementimi i sistemit të parashikimit të energjisë do të ndihmojë në menaxhimin më të mirë të të gjitha aktiviteteve të programimit të energjisë, në rritjen e saktësisë së programeve të propozuara të energjisë duke reduktuar në këtë mënyrë shmangiet që shkaktohen nga portofoli i klientit tarifor në perspektivë afatshkurtër dhe afatmesme.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

7.4.3. OPEX të tjera – aktivitete të reja në Administrimin e Përgjithshëm

Arkivimi dhe menaxhimi i dokumenteve

Duke qenë se në OSSH nuk ka pasur të implementuar më parë një sistem dokumentesh dhe as sistem arkivimi, ne po përballemi me vështirësi të mëdha në gjetjen e dokumenteve nga e kaluara në rastet kur ato nevojiten. Kjo na pengon jo vetëm për të siguruar të dhëna historike por edhe në efektivitetin e shërbimeve që i ofrojmë klientit. Si rrjedhojë, është shumë e vështirë të zgjidhet çfarëdolloj problemi që na paraqitet pasi është e vështirë të gjehen të dhënat historike. Në mënyrë që në të ardhmen ne të jemi në gjendje t'u ofrojmë klientëve cilësinë më të lartë të shërbimit si dhe t'u përgjigjemi kërkesave të çdo institucioni që kërkon raporte, përfshirë ERE-n dhe të tjerë, ne kemi në plan që të fillojmë një projekt i cili do të sjellë zgjidhje profesionale në këtë fushë. Aktualisht ne kemi shpallur një tender për të lidhur kontratë me një kompani të jashtme e cila do të ishte e aftë të menaxhonte detyra të tilla, pasi, bazuar në përvojën tonë, menaxhimi i brendshëm i dokumenteve zakonisht është më pak efektiv dhe më shumë i kushtueshëm. Kjo u konfirmua gjithashtu edhe nga rezultatet e raundit të parë të tenderit.

Ky projekt do të zgjidhë jo vetëm problemin e ruajtjes fizike të dokumenteve por edhe sistemin elektronik për identifikimin dhe arkivimin e tyre (pjesërisht të skanuara) si edhe do të mundësojë kërkim dhe lokalizim të shpejtë të dokumentit qoftë në letër qoftë në formë elektronike. Kjo do të ndihmojë zgjidhjen më të shpejtë të ankesave të klientëve si dhe do përmirësojë menaxhimin efektiv të kontratave.

Sistemi i ri Burimeve Njerëzore

Implementimi i standardeve të Grupit të sistemit të Burimeve Njerëzore (do të sjellë funksione shtesë si menaxhimi i kualifikimit dhe trajnimit, gjë që do të sigurojë mbështetje të mëtejshme për zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive të punonjësve. Ne mendojmë që kjo mbështetje e automatizuar e punës së departamenteve tona të burimeve njerëzore do të kontribuojë tërthorazi në rritjen e cilësisë së punës së punonjësve tanë dhe në përmirësimin e shërbimit të klientit. Gjithashtu, ky sistem do të jetë plotësisht i integruar me sistemin tonë kontabël, duke mundësuar transferimin automatik të të dhënave. Implementimi i sistemit të ri të burimeve njerëzore është pjesë e strategjisë sonë për ta ngritur CEZ Shpërndarje sh.a. në nivelin e një kompanie shërbimesh të standardeve evropiane. Avantazhi kryesor i një sistemi të tillë është menaxhimi më i mirë i trajnimeve dhe planeve instruktuese të punonjësve tanë si kontrolli periodik i certifikimit të detyruar për shoferët, elektrikistët etj. Ky sistem do të mundësojë gjithashtu menaxhimin e duhur të zëvendësimit, çka do të sigurojë që operimi shërbimeve të klientit të mos rrezikohet nga largimi i ndonjë punonjësi të rëndësishëm, qoftë për arsye normale si dalja në pension, qoftë për shkak të ristrukturimit.

Sigurimi i të ardhurave

Aplikimi i tarifave 2012-2014

Proceset që kanë të bëjnë me prodhimin e të ardhurave (p.sh. leximi i matësit, faturimi, arkëtimi) i përkasin procesit kyç të misionit në çdo kompani shërbimesh. CEZ Shpërndarje sh.a. i trashëgoi këto procese në gjendje shumë të keqe, shpeshherë të kryera në mënyrë informale dhe të ndryshme në çdo rajon. Pas stadeve fillestare të transformimit, atributet kryesore të këtyre proceseve u përmblodhën dhe u përcaktuan qartë si dhe u implementua mbështetja e sistemit, por mrgjithate ne ende besojmë që ka ende mundësi për përmirësim. Bazuar në përvojën e kompanive të tjera në grupin e CEZ dhe kompanive të tjera të shërbimit në botë, marrja e subjekteve të tjera të specializuara për rishikimin e këtyre proceseve, transferimin e të dhënave dhe krijimin e sistemeve të mbështetjes ka rezultuar gjithnjë e dobishme për rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë. Projekte të tilla në përgjithësi sjellin rritje të saktësisë së faturave dhe ulje të gabimeve. Ne besojmë se CEZ Shpërndarje sh.a. që rishikime të tilla janë të mundshme dhe do të sjellin përfitime jo vetëm për CEZ Shpërndarje sh.a. por edhe për klientët tanë.

Infrastruktura e IT-së

Duke shpënë më tej aktivitetet e realizuara gjatë viteve 2010-2011, do të na duhet të vazhdojmë me formësimin e infrastrukturës së IT-së së Kompanisë sipas standardeve evropiane, si në lidhje me hardware, ashtu edhe me software. Kemi në plan të mbulojmë të gjitha liçensat e munguara për programet dhe mjetet e përdorura si dhe të vazhdojmë të sigurojmë linjat e lidhjes së të dhënave me zyrat e Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit në të gjithë vendin.

7.4.4. OPEX të tjera – Aktivitete të pallogaritura

Gjatë llogaritjes së kostos për periudhën 2012-2014, ne kemi marrë në konsideratë vetëm faktet që ne njohim aktualisht dhe që mund të parashikohen deri diku me njëfarë saktësie. Megjithatë, jemi të ndërgjegjshëm që ka diskutime ende të hapura rreth subjekteve që mund të ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në funksionimin dhe për pasojë edhe në nivelin e kostos të CEZ Shpërndarje. Këto fakte nuk janë marrë parasysh pasi vlerësimi dhe llogaritja përkatëse e efekteve të kostos janë parimisht të paparashikueshme për momentin. Ne gjithsesi mendojmë se në rast se këto efekte do të konkretizohen në të ardhmen gjatë periudhës rregullatore aktuale, niveli i OPEX do të rivlerësohet dhe si rrjedhojë do të pasqyrohet tek tarifat.

Pasojat e tilla mendojmë se do të vijnë kryesisht, por jo vetëm, nga diskutimet mbi ligjin e ri për burimet e rinovueshme, sidomos në lidhje me detyrimin për të mirëmbajtur linjat e burimeve të sapolidhura të energjisë, me përmirësimin e linjave aktuale me qëllim mbështetjen e burimeve të reja, ristrukturimin e stafit të qendrave të dispaçerisë etj.

Ajo që është krejtësisht e paparashikueshme për momentin është efekti i nje ndarje te mundshme totale të aktiviteteve të OSSH-së dhe FPP-së dhe liberalizimi I plotë I tregut të energjisë në Shqipëri, gjë që disa burime e parashikojnë se do të ndodhë më 1 janar të vitit 2015. Nëse diçka e tillë ndodh,

Aplikimi i tarifave 2012-2014

pjesa më e madhe e kostos që lidhet me të, do të duhet të shpenzohet brenda vitit 2014 dhe për këtë arsye ne mendojmë se këto kosto do të pasqyrohen në rishikimin përkatës të tarifave për vitin përkatës.

7.5. Parimet e alokimit për alokimin e kostos midis OSSH dhe FPP

Siç e thamë më lart, Kompania është e organizuar në dy divizionë kryesorë - Shitje dhe Shpërndarje. Atje ku është kosto efektive, funksionet e suportit ndahen dhe sigurohen nëpërmjet departamenteve të vecanta- E përgjithshme & Administrata, Financa dhe Auditit i Brendshëm. Nga njëra anë, një organizim i tillë është efikas në kosto, meqë disa nga funksionet nuk janë të dublikuar, nga ana tjetër kërkon një alokim kostoje të dytë për divizionet kryesore përkatëse në mënyrë që të vëjë OPEX-in e plotë të kompanisë në funksion të OSSH dhe FPP.

Nga njëra anë, dërgimi i të dhënave kontabël përcaktohet në atë mënyrë që siguron të dhëna të qarta, por nga ana tjetër ai mbahet në nivel granulariteti i cili manaxhohet lehtësisht dhe qartë.

Për shembull, faturat për ndërtesat me qira me hapësira të zakonshme, të cilat janë të zëna nga disa departamente, dërgohen si një element i vetëm në Qendrën e Kostove të Menaxhimit të Kompleksit pa e ndarë atë në shumë elementë dhe drejtime, gjë e cila do të krijojë më shumë ngarkesë pune dhe kosto. Në këtë rast alokimi i kostove bëhet në një alokim të dytë kostosh i bazuar në çështje kyçe statistike, në këtë rast të llogaritur në bazë të sipërfaqes në metra katrorë që zë secili departament.

Më poshtë gjendet përshkrimi i parimeve që përdoren për alokimin. Alokimin e kostos sekondare e bëjmë në “dy hapa” si vijon:

Alokimi i parë i kostos sekondare:

Kostot të cilat dërgohen të parat tek Qendrat e kostos së funksioneve mbështetëse alokohen tek Qendrat e kostos të së tri divizioneve ku përfshihen funksionet mbështetëse. Shembulli i kostove rentale të përmendura më lart është ilustrues - pas alokimit të kostos së parë sekondare, kostot rentale i alokohen Qendrave përkatëse të Kostos ku përfshihen, për shembull, Financa, Burimet Njerëzore, Departamenti Ligjor etj, bazuar në hapësirën që zënë. Alokime të tjera kyç, përveçse sipërfaqes, janë edhe numri i automjeteve të përdorura në pronësi dhe atyre me qera si dhe numrin e punonjësve. Alokimet kyç përdoren në numrin e Llogarisë, bazuar në natyrën e kostos së vendosur në një llogari të tillë. Si shembull i mëtejshëm mund të shërbejë alokimi i kostos për materiale zyre, toner etj, i cili alokohet bazuar në numrin e punonjësve në departamentin përkatës.

Rezultati i një alokimi të tillë është një përmbledhje e kostove të drejtpërdrejta në Qendrën përkatëse të Kostos ku përfshihen edhe funksionet mbështetëse.

Alokimi i kostos së dytë sekondare:

Aplikimi i tarifave 2012-2014

Hapi i fundit në alokime është ndarja e kostove midis funksioneve të OSSH dhe FPP të Kompanisë. Një alokim i tillë bëhet bazuar në numrin punonjësve në të dyja divizionet kryesore dhe kostot e funksioneve mbështetese i alokohen në përputhje me një element të tillë, Qendrave përkatëse të Kostos të divizioneve të Shitjes dhe Shpërndarjes. Bazuar në të gjitha këto, mund të bëhet vlerësimi i totalit të kostove Direkte dhe Indirekte për çdo funksion të OSSH dhe FPP. Atëherë këto kosto përfundimtare përdoren për llogaritje të mëtejshme të alokimit të kostos sipas funksioneve të ndryshme si Matja, Faturimi etj.

7.6 Përmbledhje e përgjithshme OPEX

Përmbledhja e të gjitha shpenzimeve Operative dhe alokimi i tyre tek OSSH dhe FPP, si dhe ndarja e kostove të shërbimeve të Përbashkëta jepen në **Shtojcën nr.3**.

Siç shohim dhe nga grafikët e Shtojcës nr. 3, rritja e shpenzimeve të kërkuara Operative vjen nga projektet e reja të planifikuara për periudhën rregullatore 2012-2014. Me përjashtim të projektit për verifikimin e matësve, ne jemi të bindur se të gjitha këto projekte do të sjellin një shtytje dhe një përmirësim të shërbimeve për klientët tanë, reagime më të shpejta në kohë, një kontroll më të mirë të aktiviteteve të kryera dhe në këtë mënyrë mundësi më të mirë për të reaguar dhe rregulluar proceset në mënyrë që të përmirësohet cilësia e shërbimeve të ofruara.

Do të donim të theksonim se shumica e plotë e shpenzimeve Operative të kërkuara për 2012, pasi janë përjashtuar projektet e reja të lartpërmendura, është paksa në një nivel më të ulët sesa niveli i shpenzimeve të miratuara nga ERE për vitin 2011. Duke marrë parasysh inflacionin dhe rritjen e kostove të punës, do të donim të nënvizonim se përmirësimet në efikasitetin e proceseve të kompanisë të sjella nga CEZ Shpërndarje sh.a, lejuan që të mbahet një nivel konstant i kostove operative, që do të thotë një përfitim për klientët që nuk janë dëmtuar nga inflacioni.

8. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

8.1.1 OPEX (Shpenzimet operationale)

Niveli fillestar i shpenzimeve operationale për OSSH për 2012 është 8.120.129 mijë LEKË. Për vitet 2013 dhe 2014, do të përdoret klauzola e indeksimit, siç përshkruhet në kapitullin 11.6.

8.2 CAPEX

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Dy vjet pasi operojmë në tregun energjetik në Shqipëri, ne mund të përshkruajmë më me saktësi situatën në rrjetin lokal dhe qëndrimin e të gjithë aktorëve në vend. Mund të konfirmojmë idenë që rrjeti i cili ka pasur shumë pak investime, është krejtësisht i rrënuar dhe është në fund të ciklit të jetëgjatësisë së tij. Ne duhet gjithashtu të vëmë theksin mbi përqindjen e vjedhjeve të energjisë elektrike në shoqërinë shqiptare, ndërkohë që faktori ndëshkues nëpërmjet gjobave, proceseve gjyqësore, titujve ekzekutivë e kështu me radhë nuk po ndryshon në mënyrë të dukshme.

Por është e domosdoshme të nënvizojmë se mungesa e kapacitetit elektrik në shumicën e zonave industriale, zonave turistike etj, pengon zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Është e domosdoshme të kujtojmë se buxheti për investimet e CEZ Shpërndarje sh.a në vitin 2010 u tejkalua pavarësisht se ndarja e projekteve të veçanta të investimeve ishte ndryshe nga ai i parashikuar. Arsyeja ishte kryesisht përmbushja e detyrimit të KESH dhe OST të nënshkruar në marrëveshjen për privatizim. Ky rezultat i mirë nuk do të mund të përsëritet në vitin 2011. Arsyeja kryesore është pamundësia e sigurimit të huase afatgjate të investimeve pasi autoritetet lokale nuk miratuan deklaratën e kërkuar nga Bankat EBRD dhe IFC. Për shkak të vonësës së lartpërmendur, ne presim realizimin e gjysmës së planit të parashikuar d.m.th. 2.4 miliardë LEK. Por nga ana tjetër, ne jemi të përgatitur që pjesën tjetër të planit të vitit 2011 ta shpenzojmë në vitet në vijim, duke supozuar mundësimin e kredise (kushte të tjera për disbursimin janë miratimi i studimit të Borxhit të Keq dhe deklarata e ERE-s mbi principet për Deklaratën Rregullatore për periudhën përtej 2015). Nëse mbështetja e qeverisë shqiptare dhe autoriteteve lokale do të jetë më e mirë se sa vitin që jemi. CEZ Shpërndarje sh.a beson se nivelet e propozuara për investimet janë të pranueshme dhe mund të përfundohen gjatë periudhës 2012-2014.

Plani ynë i Investimit synon të japë rezultatet e mëposhtme:

- (i) Të ulë humbjet teknike dhe jo-teknike në rrjetin shpërndarës. Veçanërisht për këtë problem ne jemi duke ndjekur hollësisht Studimin për Humbjet, i realizuar nga kompania audituese Price Waterhouse Coopers dhe miratuar nga ERE në vitin 2010.
- (ii) Të fuqizojë kapacitetin e shpërndarjes së energjisë për të furnizuar me energji të plotë veçanërisht zonat turistike dhe zonat qendrore që janë përreth Tiranës. Kjo pjesë është në harmoni të plotë me synimet e qeverisë shqiptare dhe OST, të përmendura në kapitullin tjetër.
- (iii) Të nxisim efikasitetin dhe cilësinë e furnizimit me energji.

Strategjia e detajuar e investimeve përshkruhet në një dokument të veçantë që do t'i dorëzohet ERE-s në ditët e para të shtatorit 2011.

8.2.1 CAPEX 2010

Plani i Investimit fillestar për vitin 2010 i miratuar nga ERE në shumën 4,3 miliardë LEK, u tejkalua dhe shifrat ju dërguan ERE-s si pjesë e aplikimit të tarifave për vitin 2011 në shumën 4.5 miliardë lekë.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Kapitalizimi aktual i investimeve të reja në 2010 ka arritur nivelin 4,68 miliardë lek me ndarjen e pasqyruar në grafikun e mëposhtëm.

ADDITIONS 2010		
Description	Class	ADDITIONS 01.01-31.12.2010
Land with Buildings	3120	22 475 212,50
Land improvements and arrangements	3110	266 708 225,85
Technical Buildings	2110	332 811 133,25
Construction	2120	147 741 547,55
Other Machinery and Equipments	2230	1 855 336 166,43
Transformatore	2230	795 607 512,79
Linja ajrore (TL)	2230	67 389 009,31
Linja ajrore (TM)	2230	249 476 707,28
Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	
Linja nentokesore (TM)	2230	
metering	2240	749 625 993
Efekti i saktë financiar nga llogaritja e kompensimit të Borxhit të Keq jepet në kapitullin 10.6

Aplikimi i tarifave 2012-2014

		2009	2010	2011
Niveli i Borxhit të Keq i përdorur në llogaritjet historike	%	14	13	12
Niveli i Borxhit të Keq sipas studimit të Borxhit të keq	%	20,71	20,71	19,71

Fig 23. Vlerat e Borxheve të Këqija për kompensimin

10.2 Kompensimi i kostove të blerjes së humbjeve për vitin 2011

Kompensimi i kostove të blerjes së humbjeve për vitin 2011 llogaritet në bazë të çmimit të ri të parashikuar për energjinë, kursin e këmbimit dhe parashikimin e kërkesës për vitin 2011. Të gjitha të krahasuara me nivelin e miratuar për vitin 2011. Vlerat e çmimit për humbjet dhe kursi i këmbimit të përdorura në llogaritje janë dhënë në tabelën 24.

Efekti i saktë financiar nga llogaritja e kompensimit për Humbjet është dhënë në kapitullin 10.6.

		2011
Çmimi i blerjes së energjisë për humbjet , i miratuar nga ERE ne perllogaritjen e të Ardhurës së Kërkuar.	EUR/MWh	50,29
Niveli i kursit të këmbimit i miratuar nga ERE për llogaritjen e të Ardhurës së Kërkuar.	LEK/EUR	138,00
Niveli i humbjeve të llogaritura në bazë të kërkesës së miratuar (27,92 %)	MWh	1 547 352
Çmimi i parashikuar i blerjes së energjisë për humbjet , i përdorur për llogaritjen e kompensimit.	EUR/MWh	50,38
Niveli i parashikuar i kursit të këmbimit, i përdorur për llogaritjen e kompensimit.	LEK/EUR	141,10
Niveli i humbjeve, i llogaritur në bazë të kërkesës së re të parashikuar(27,92 %)	MWh	1 755 055

Fig 24. Kostot e vlerave të humbjeve për kompensimin.

Çmimi i parashikuar i blerjes së energjisë dhe niveli i parashikuar i kursit të këmbimit, llogariten në bazë të blerjes reale për periudhën janar-korrik 2011 (ku përfshihet kursi real i këmbimit) dhe blerja e parashikuar deri në fund të vitit (ku përfshihet kursi i parashikuar i këmbimit). Mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë dhe kursi i këmbimit, janë dhënë në tabelën e mësipërme (e ponderuar mbi sasinë e energjisë)

CEZ Shpërndarje sh.a do të donte të vinte theksin në faktin se gjatë kësaj vjeshte, do të dorëzojë tek ERE, çmimin e përditësuar të blerjes dhe kursin e këmbimit bazuar në blerjet reale progressive.

10.3 Kompensimi i diferencës midis planit dhe parshikimit të ri të kërkesës për vitin 2011

Kompensimi i diferencës midis planit dhe parshikimit të ri të kërkesës, llogaritet në bazë të parshikimit të kërkesës së re, e krahasuar me planin e miratuar për vitin 2011. CEZ Shpërndarje sh.a, do të donte të theksonte se diferenca e madhe midis planit dhe parshikimit të kërkesës së re është shkaktuar si pasojë e rritjes së paparashikuar të konsumit, venanërisht në tensionin e lartë.

Në nivelin e tensionit të lartë është lidhur një klient dhe nderkohe një klient tjetër është lidhur përsëri nga tensioni i mesëm në atë të lartë. (përkthyer në kapitullin 6.1.2).

Vlerat e parshikimit të kërkesës të përdorura në llogaritjen e kompensimit janë dhënë në tabelën 25.

Ndryshimi i kërkesës ka dy efekte. Njëri kërkon të blihet më shumë energji nga FPSH dhe OST (kosto më e lartë ose kompensim pozitiv) dhe i dyti kërkon të ardhura më të mëdha nga tarifat e konsumatorit (kompensim negativ). CEZ Shpërndarje sh.a perlllogarit të dyja efektet dhe efekti i saktë financiar jepet në kapitullin 10.6

		2011
Kërkesa për TL e miratuar nga ERE për vitin 2011	MWh	240 000
Kërkesa për TM dhe TU miratuar nga ERE për 2011	MWh	3 994 741
Parashikimi i kërkesës së re për TL për 2011	MWh	602 964
Parashikimi i kërkesës së re për TM dhe TU për 2011	MWh	4 530 960

Fig 25. Vlerat e kërkesës për kompensim.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

10.4 *Kompensimi i vlerës së Aseteve për vitin 2011, nga investimet e ndryshme të vitit 2011*

Kompensimi i normes të kthimit të Aseteve, llogaritet duke u bazuar në diferencën midis vlerave të planit të Aseteve të vitit 2011, miratuar nga ERE dhe nivelit të ri të parashikuar të Aseteve, i llogaritur në bazë të investimeve reale të vitit 2010 dhe investimet e reja të parshikuara për vitin 2011. Në llogaritje është përfshirë edhe niveli i ri i amortizimeve për vitet 2010 dhe 2011. Niveli i ri i amortizimit për vitin 2011 është gjithashtu subjekt i kompensimit për sa i përket amortizimit të parametrave (jo vetëm pjesë e nivelit të Aseteve, por edhe amortizime “të pastra” të cilat janë pjesë e të Ardhurës së Kërkuar).

Vlerat e cdo elementi përfshirë në Asete jepen në tabelën 26.

Efekti i saktë financiar nga llogaritja e kompensimit të humbjeve jepet në kapitullin 10.6.

		Miratuar për vitin 2011	Llogaritja e re për vitin 2011
Vlera kontabile e bilancit IFRS 2007	mil. LEK	16 329,000	16 329,000
Vlera e investimit të bërë për 2008	mil. LEK	1 953,520	1 953,520
Asetet e financuara nëpërmjet granteve	mil. LEK	-770,000	-770,000
Asetet e ndërtuara nga KESH për OSSH dhe transferuara tek OSSH	mil. LEK	1 100,000	1 100,000
Vlera e investimit të bërë për 1-5/2009	mil. LEK	3 287,206	3 287,206
Vlera e investimit të bërë për 6-12/2009	mil. LEK	617,654	617,654
Vlera e investimit të parashikuar për 2010	mil. LEK	4 540,267	4 681,529
Vlera e investimit të parashikuar për 2011	mil. LEK	4 896,000	2 395,963
	mil. LEK		
Amortizimi 2008	mil. LEK	2 016,788	2 016,788
Amortizimi 2009	mil. LEK	2 449,211	2 449,211
Amortizimi 2010	mil. LEK	2 621,636	2 545,767
Amortizimi 2011	mil. LEK	3 126,076	3 176,352
Baza e Asetit 2011 pa kapitalin qarkullues	Mijë LEK	19 291,936	18 208,771

Fig 26. Vlerat e Aseteve për kompensimin

10.5 *Kompensimi i amortizimit të asetëve të blera para privatizimit*

Kompensimi i amortizimit para blerjes, përmban mekanizmin për llogaritjen e amortizimit të asetëve të kapitalizuara para datës së blerjes, i miratuar nga ERE, si pjesë e vendimit mbi tarifën për vitin 2011. Mekanizmi bazohet në jetëgjatësinë të vlefshme të mbetur (RUL) të asetëve të blera para blerjes.

Diferenca në amortizim është e ndarë përgjatë RUL dhe cdo vit do të aplikohet si pjesë e kësaj diference.

Për vitin 2012, diferenca është në nivelin e 229 370 946 LEK, i cili i shtohet drejtpërdrejt nivelit të amortizimit të parashikuar për 2012.

10.6 Llogaritja e plotë e kompensimit për vitet 2009, 2010 dhe 2011

Në tabelën e mëposhtme nr. 27, mund të gjeni llogaritjen përkatëse të kompensimit për vitin 2009, bazuar në nivelin e borxhit të Keq të ri, përfshirë reduktimin e WACC kur lindin të drejtat në fillim të vitit 2012.

mil. LEK	2009
e Ardhura e Kërkuar e miratuar	36 304,094
e Ardhura e Kërkuar e re	40 163,573
Diferenca	3 859,478
Duke përdorur WACC 2009, 2010, 2011	1 200,486
Kompensimi i plotë	5 059,964

Fig 27. Kompensimi për vitin 2009

Në tabelën e mëposhtme nr. 28, mund të gjeni llogaritjen përkatëse të kompensimit për vitin 2010, bazuar në nivelin e borxhit të Keq të ri, përfshirë zbritjen e WACC kur lindin të drejtat në fillim të vitit 2012.

mil. LEK	2010
e Ardhura e Kërkuar e miratuar	42 760,688
e Ardhura e Kërkuar e re	47 725,207
Diferenca	4 964,519
Duke përdorur WACC 2010, 2011	1 067,665
Kompensimi i plotë	6 032,184

Fig 28. Kompensimi për vitin 2010

Në tabelën e mëposhtme nr. 29, do të gjeni llogaritjen përkatëse të kompensimit për vitin 2011, bazuar në nivelin e borxhit të Keq të ri, në parashikimin për kërkesën, në koston e blerjes së humbjeve, asetet përfshirë zbritjen e WACC të borxhit të Keq kur lindin të drejtat në fillim të vitit 2012

mil. LEK	Miratuar 2011	e Ardhura e Kërkuar e re
Norma e Kthimit të Aseteve	2 077,245	1 984,505
Amortizimi	3 126,076	3 176,352
Kostoja e humbjeve	11 667,000	13 529,052
Shpërndarja OPEX	6 697,000	6 697,000
Kompensimi i Humbjeve dhe Amortizimit	2 421,462	2 421,462

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Lidhja e re dhe të Ardhura të tjera	-580,000	-580,000
Të Ardhurat e energjisë reaktive	-235,000	-235,000
e Ardhura OSSH	25 173,783	26 993,371
Kostoja e blerjes së energjisë	8 819,849	10 678,561
FPP Marzh	138,132	167,161
OPEX FPP	1 875,492	1 875,492
Borxh i Keq	4 349,071	9 864,596
Duke përdorur WACC 2011 për Borxhin e Keq		550,449
e Ardhura FPP	15 182,544	23 136,259
e Ardhura e Plotë	40 356,327	50 129,630
Kompensimi i Plotë		9 773,303

Fig 29. Kompensimi për vitin 2011

Siç u përmend në kapitullin 10.3 për vitin 2011, është gjithashtu domosdoshme të bëjmë llogaritjen e një të ardhure më të lartë nëpërmjet një kërkesë më të lartë. Llogaritja bëhet në bazë të kërkesës së re të pritshme nga çdo kategori konsumatori dhe tarifave përkatëse të cilat janë miratuar për vitin 2011.

Në tabelën e mëposhtme nr. 30, jepet diferenca midis të ardhurës së miratuar për vitin 2011 dhe të ardhurës së re të pritshme të llogaritura në bazë të kërkesës së re dhe tarifave të miratuara.

E ardhura e miratuar 2011 (mil. LEK)	40 356,327
E ardhura e re e pritshme 2011 (mil. LEK)	49 355,569
Kompensimi i të ardhurës (mil. LEK)	- 8 999,242

Fig 30. Kompensimi i të ardhurës për vitin 2011

Në tabelën e mëposhtme nr. 31, do të gjeni përmbledhjen e llogaritjes së kompensimit për periudhën e tretë rregullatore.

Kompensimi për vitin 2009 (mil. LEK)	5 059,964
Kompensimi për vitin 2010 (mil. LEK)	6 032,184
Kompensimi për vitin 2010 (mil. LEK)	9 773,303
Kompensimi për të ardhurën (mil. LEK)	- 8 999,242
Kompensimi i plotë për periudhën e tretë rregullatore	11 866,209

Fig 31. Përmbledhje e llogaritjes së kompensimit për vitet 2009, 2010 dhe 2011

Kompensimi i plotë ndahet midis shpërndarjes dhe Furnizimit, duke u bazuar në origjinën e çdo parametri që lidhet me biznesin e shpërndarjes ose të furnizimit.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Shpërndarja mbulon kompensimet e Aseteve, amortizimin dhe koston e humbjeve.

Furnizimi mbulon pjesën tjetër të kompensimeve (Borxhi i Keq, kostoja e blerjes së energjisë, marzhi FPP dhe ndryshimi i kërkesës.)

Rezultati nga kjo ndarje tregohet në tabelën Nr. 32.

Kompensimi i plotë për periudhën e tretë rregullatore (mil. LEK)	11 866,209
Shpërndarja (mil. LEK)	1 819,588
Furnizimi (mil. LEK)	10 046,621

Fig 32. Ndarja e kompensimit midis Shpërndarjes dhe FPP

Të gjitha kompensimet e lartpërmendura janë përdorur në llogaritjen e të Ardhurës së Kërkuar për tre vitet në vazhdim. CEZ Shpërndarje sh.a, nuk është e interesuar të krijojë deflacion të papritur në çmime.

CEZ Shpërndarje sh.a, propozon të shpërndajë kompensimin e plotë në të gjithë periudhën e tretë rregullatore, i zbritur nga WACC dhe të mbajë vendosjen e çmimit brenda një limiti të arsyeshëm.

Gjithashtu ulja e mëtejshme e programit të humbjeve dhe programit borxheve të Këqija, do të krijojnë më shumë hapësirë për amortizimin e kompensimit.

10.7 Kompensimi për vitet 2013 dhe 2014

Subjekti i kompensimit të viteve 2013, 2014 dhe viteve në vazhdim, do të jetë kompensimi i amortizimit të aseteve të marra para blerjes. Subjekti tjetër i kompensimit do të jetë parashikimi i kërkesës dhe kostoja e humbjeve sipas viteve përkatëse.

Për vitin 2013, kompensimi amortizimit të aseteve të marra para blerjes është në nivelin prej 229,371 mil. LEK.

Për vitin 2014, kompensimi amortizimit të aseteve të marra para blerjes është në nivelin prej 208,405 mil. LEK.

Në bazë të parimit të përshkruar në kapitullin e mëparshëm, gjatë vitit 2013 dhe 2014 do të kompensohet edhe pjesa tjetër e kompensimit e cila nuk do të përfshihet në tarifën për vitin 2012.

11. Kërkesa për të ardhura për 2012 - 2014

11.1 Të ardhura të tjera

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Të ardhurat e tjera mund të ndahen në dy kategori: së pari, lidhjet e reja dhe së dyti, të ardhurat shtesë (për shembull: ndryshimi i kontratës, rialokimi i matësit, ndryshimi i pikës së lidhjes, rilidhja etj).

Për llogaritjen e të ardhurave të pritshme që lidhen me lidhjet e reja përdoren të dhëna historike nga viti 2010 dhe gjysma e vitit 2011 – shih tabelën e mëposhtme. Në tabelë, vihet re trendi në rënie i lidhjeve të reja në tensionin e ulët.

Numri i lidhjeve të reja	2010	H1 2011
Tension i mesëm	374	198
Tensioni i ulët	22 068	7 471
Të ardhura nga lidhjet e reja (lekë)	540 453 375	224 742 190

Fig 33 Të ardhurat nga lidhjet e reja

Për të ardhurat shtesë, të ardhurat historike pasqyrohen në tabelën në vijim.

	2010	H1 2011
Të ardhurat shtesë (lekë)	11 908 850	6 749 499

Fig 34 Të ardhurat shtesë

Të ardhurat e vlerësuara të CEZ Shpërndarje nga lidhjet e reja dhe të ardhurat shtesë janë në nivelin e 500 milionë lekë për vitin 2012 dhe e njëjta shifër për vitin pasues. Të ardhurat e pritshme zbriten nga të ardhurat e Kërkuara të Shpërndarjes përpara ndarjes së tyre në tarifatat përkatëse të Shpërndarjes.

11.2 Të ardhurat nga energjia reaktive

CEZ Shpërndarje ka përdorur për vlerësimin e të ardhurave të pritshme të dhënat historike të energjisë reaktive të vitit 2010 dhe gjysmës së parë të vitit 2011. Për vitin 2010, ne u kemi tarifuar konsumatorëve energji reaktive në nivelin 108 milionë lekë.

Aplikimi i tarifave 2012-2014


Në bazë të energjisë reaktive të matur dhe instalimit progresiv të matësve Converge, gjë që solli matje më të saktë të energjisë reaktive, CEZ Shpërndarje parashikon të ardhura nga energjia reaktive në nivelin e 300 milionë lekë për vitin 2012 dhe të njëjtën shumë për vitet pasuese.

Vlera përkatëse është zbritur nga të ardhurat e Shpërndarjes përpara ndarjes në tarifa përkatëse të Shpërndarjes.

11.3 Të ardhura nga energjia në pik

CEZ Shpërndarje do të dëshironte të propozonte një raport të ndryshëm ndërmjet çmimit të pikut dhe të bazës (duke krahasuar me situatën aktuale), i cili do të bazohej vetëm në çmimin e energjisë (vetëm tarifën e furnizimit pa tarifën e shpërndarjes). Çmime të ndryshme për pikun dhe bazën tentojnë të kenë barazi në diagramë duke filluar nga prodhuesit e duke mbaruar tek konsumatorët. Duke iu referuar një analize afatgjatë, raporti ndërmjet çmimit të energjisë së bazës dhe pikut në tregun e shitjes me shumicë është afërsisht në nivelet 15 – 20 %; më poshtë, tabela dhe grafiku ofrojnë ilustrime.

CEZ Shpërndarje propozon të mbahet një limit më i ulët dhe të përcaktojë çmimin e pikut 15% më të lartë sesa çmimi i bazës.



Legjenda: --- ELIX Piku --- ELIX Basa

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Faqe 77 nga 110

Fig 35 Marrëdhënia ndërmjet çmimit pik dhe bazë EEX

Phelix Futures - 25. August 2011, 18:30:00					
Contract	Price Base	Contract	Price Peak	Contract	Price Off-Peak
W35/11	51.00 €/MWh	W35/11	59.58 €/MWh		
Sep-11	54.29 €/MWh	Sep-11	64.40 €/MWh	Sep-11	48.44 €/MWh
4.11	63.06 €/MWh	4.11	80.23 €/MWh	4.11	53.69 €/MWh
Cal-12	57.59 €/MWh	Cal-12	71.36 €/MWh	Cal-12	49.96 €/MWh

FiFig 36 Marrëdhënia EEX të ardhshëm ndërmjet çmimeve në pikë dhe bazë

11.4. *Përfshirja e komponentit fiks tarifor*

Në përputhje me nenin 9 të metodologjisë së llogaritjes së sistemit të shpërndarjes së energjisë dhe përfshirjes graduale të praktikave standarde evropiane në strukturën e tarifave, CEZ Shpërndarje deklaron gatishmërinë për të paraqitur komponentin fiks për energjinë e instaluar nga klientët e lidhur në TL dhe TM, duke filluar nga viti 2012.

CEZ Shpërndarje është në dijeni të nevojshmërisë për ndryshime graduale në ristrukturimin e strukturës së plotë të tarifës ekzistuese. CEZ Shpërndarje e gjykon përfshirjen e komponentit fiks në TL dhe TM si fillim i pak viteve të procesit të vazhdueshmërisë që do të ndihmojë në funksionimin efektiv të rrjetit, në mirëmbajtjen e rrjetit, si edhe në identifikimin e rezervave të kapacitetit të rrjetit, duke përfshirë instrumentet efektive.

Pagesa për fuqinë e instaluar do të sjellë gjithashtu modifimin e konsumatorëve për të negociuar/përditësuar për fuqinë e nevojitur për bizneset e tyre dhe ta përdorin me efikasitet këtë energji. Në këtë mënyrë, OSSH do të jetë në gjendje të përdorë linjat aktuale më efektivisht për më shumë konsumatorë me siguri më të lartë. Eksperienca e tanishme tregon se një numër i vogël konsumatorësh ulin fuqinë e tyre të rezervuar, p.sh. kur ndryshojnë biznes. Ky komponent do të nxisë gjithashtu konsumatorët të sheshojnë diagramën e tyre të ngarkesës me pritshmërinë për të konsumuar të njëjtën energji, por me volum më të ulët maksimal – fuqi e rezervuar.

Struktura e tarifës do të ndjekë gjithashtu logjikën ekonomike të kostove të kompanisë – kosto fikse dhe kosto variable. Me sigurimin e gatishmërisë së sistemit janë të lidhura kontot fikse që duhet të lidhen me komponentët fiks. Kostot fikse (ose minimalisht, disa pjesë të tyre) duhet të mbulohen nëpërmjet komponentit të tarifës fikse, sepse CEZ Shpërndarje e mban rrjetin të gatshëm për furnizim në çdo moment dhe kostot variable (humbjet) duhet të mbulohen nga komponenti variabël i tarifës.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Fuqia e instaluar është vlera që konsumatorët kanë në çdo moment në dispozicion dhe mund ta përdorin. Vlera e fuqisë së instaluar varet nga pika e lidhjes dhe është e ndryshme për çdo konsumator. CEZ Shpërndarje ka në dispozicion të dhëna rreth fuqisë së instaluar nga shumica e klientëve të lidhur në TM dhe është gjithashtu në proces të aktualizimit të këtyre të dhënave.

Llogaritja e komponentit fiks për fuqinë e instaluar është bërë mbi bazën e shpenzimeve të matura operacionale që lidhen me klientët e mëdhenj (matësit converge) dhe asetet e matjes që lidhen me nivelin e TM. Llogaritja konkrete pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

OPEX të lidhura me komponentin fiks (mil. Lekë)	159 700,822
Asetet të lidhura me komponentin fiks (mil. Lekë)	60 928,166
WACC	9,721%
Të ardhura totale për çmimin fiks (mil. Lekë).	165 623,649
Kapaciteti i rezervuar (KW)	687 490
Çmimi fiks për fuqinë e instaluar (Lekë/kW/muaj)	20

Fig 37. Llogaritja e komponentit fiks

11.5. Korrigjimi i mbulimit të humbjeve të transformatorëve

Në përputhje të eliminimit gradual të mos-transparencës në strukturën e tarifës, në do të dëshironim t'i sugjeronim ERE's përfshirjen e parimit për të mbuluar koston e humbjeve nga klientët që maten në anën sekondare të transformatorit që është në pronësi të tyre, por të tarifuar me çmimet e konsumatorëve të lidhur në TM.

Çdo konsumator duhet të ketë elektromatës në pikën e lidhjes, por disa konsumatorë që kanë transformatorë në pronësi kanë elektromatës të vendosur në anën sekondare të transformatorit (arsye teknike), por janë tarifuar me çmime për TM.

Ne jemi dakord që këta klientë duhet të tarifohen me çmime të TM, por në transformator ka humbje të ngarkesës dhe mos-ngarkesës, që duhet t'i alokohet drejtpërdrejt pronarit të transformatorit.

Nga ky pikëshikim, ne do të dëshironim t'i kërkonim ERE-s përfshirjen e parimit të mëposhtëm:

- jo më shumë se 4 % për marrjen nga rrjetet e TM , ose

Aplikimi i tarifave 2012-2014

- një shumë të llogaritur sipas **Shtojcës 5** më pshtë. Nëse konsumatori i kërkon kompanisë së shpërndarjes të llogarisë humbjet dhe i siguron informacion kërkuara për të tilla perlllogaritje.

Sasia e enrgjisë së rregulluar në këtë mënyrë do të jetë themeltare për llogaritjen e pagesave te shitjes dhe shpërndarjes. Mundësia e dytë (sipas parametrave realë të transformatorit) do të përdoret nga dita e parë e muajit kalendarik pas muajit në të cilin konsumatori i jep kompanisë së shpërndajes parametrat e transformatorit, sipas **Shtojcës 5**, deri në ditën e 15-të të atij muaji.

11.6. Parametrat fiks dhe variabël gjatë periudhës rregullatore

Duke marrë në konsideratë faktin se periudha e ardhshme rregullatore do të zgjasë 3 vjet, CEZ Shpërndarje do të dëshironte të propozonte parametra që do të qëndrojnë të fiksuar për të gjithë periudhën dhe parametra te cilet do të ndryshojnë çdo vit.

Parametrat fiks që duhet të vendosen në fillim të periudhës rregullatore dhe mbahen gjatë të gjithë perudhes janë:

- Shpërndarja
 - OPEX, ndryshim vjetor me indeks të kombinuar
 - Vlera e Aseteve – mesatare e llogaritur mbi vlerën e pritshme për tre vitet e ardhshme
 - Amortizimi – mesatarja e llogaritur mbi vlerën e pritshme për tre vitet e ardhshme
 - Kompensimi total për tre vjet dhe pjesa që do të mbulohet gjatë vitit 2012
- Furnizimi (FPP)
 - OPEX, ndryshim vjetor me indeks të kombinuar
 - Kompensimi total për tre vjet dhe pjesa që do të mbulohet gjatë vitit 2012

CEZ Shpërndarje ka propozuar Indeksin e Kombinuar (Combined Index -CI) që përmban dy pjesë thelbësore të shpenzimeve operative. Në të parën futen shpenzimet personale dhe në të dytën pjesa e shpenzimeve operacionale.

Shpenzimet personale, si një pjesë e rëndësishme e shpenzimeve operacionale të CEZ Shpërndarje, kanë rritje të ndryshme historike në krahasim me CPI (indeksi i çmimit të konsumatorit). Raporti i pritshëm për shpenzime operacionale përkundrejt shpenzimeve operacionale të përgjithshme është

Aplikimi i tarifave 2012-2014

në nivelin 35% (teksa shpenzimet personale përfaqësojnë rreth 35% të shpenzimeve të përgjithshme operacionale). Formula e përdorur për Indeksin e Kombinuar – CI – është:

$$CI = 0,35 \times WI + 0,65 \times CPI$$

ku:

WI indeksi i pagës vjetor i publikuar nga INSTAT

CPI çmimi vjetor i konsumatorit i publikuar nga INSTAT

Parametri baze variabël që duhet të ndryshohet çdo vit është pritshmëria e kërkesës për çdo vit. Parametrat variabël që do të ndryshojnë çdo vit të periudhës rregullatore janë:

- Shpërndarja
 - Kosto e humbjeve
 - Kapital qarkullues
 - WACC
 - Të ardhura të tjera (energji reaktive, lidhjet e reja, të ardhura shtesë)
- Furnizimi (FPP)
 - Kosto e blerjes së energjisë.

11.7. llogaritja e të ardhurave të kërkuara të përgjithshme

Të ardhurat e kërkuara të përgjithshme janë llogaritur sipas formulës rregullatore si shumë e çdo komponenti të të ardhurave. Përmbledhja e të ardhurave të kërkuara të përgjithshme për OSSH dhe FPP për sa i përket periudhës së tretë rregullatore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

TË ARDHURAT		2012	2013	2014
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes				
Të ardhurat e kërkura të Shpërndarjes	mil. lekë	28 561,528	28 263,375	27 224,685
Kosto e humbjeve	mil. lekë	14 427,335	13 410,757	11 672,822
OPEX	mil. lekë	8 120,129	8 420,573	8 732,135
Amortizimi	mil. lekë	4 196,125	4 196,125	4 175,159
Norma e kthimit	mil. lekë	2 293,810	2 395,571	2 342,258
RAB	mil. lekë	23 596,438	23 536,760	23 417,895
Asetet	mil. lekë	21 717,482	21 717,482	21 717,482
WC	mil. lekë	1 878,955	1 819,278	1 700,413
WACC	mil. lekë	9,721%	10,178%	10,002%
Shpërndaja e kompensimit	mil. lekë	324,131	640,348	1 102,311
Lidhjet e reja dhe të ardhura shtesë	mil. lekë	-500,000	-500,000	-500,000
Të ardhurat nga energjia reaktive	mil. lekë	-300,000	-300,000	-300,000
Furnizuesi Publik me Pakicë				
Të ardhurat e kërkura të Furnizuesit	mil. lekë	25 528,631	27 433,694	30 135,536
FBSH kostot e blerjes (përfshirë marzhin)	mil. lekë	8 011,433	8 249,436	8 495,770
OST kostot e blerjes	mil. lekë	3 247,878	3 344,366	3 444,231
OPEX	mil. lekë	2 127,024	2 205,723	2 287,335
Marzhi RPS	mil. lekë	176,252	181,488	186,907
Borxhet e këqija	mil. lekë	10 176,399	9 917,081	9 635,023
Kompensimi RPS	mil. lekë	1 789,647	3 535,600	6 086,271
Të ardhura të përgjithshme të kërkura	mil. lekë	54 090,160	55 697,070	57 360,221

Fig 38. Të ardhurat e kërkura

11.8. Shmangiet

Ky aplikim për tarifa është bazuar në parametrat kryesorë dhe supozime të cilat janë thelbësore për llogaritjet e tarifave të reja të propozuara. Ndër të tjera, parametrat dhe supozimet kryesore janë të vlefshme deri në datën e dorëzimit të aplikimit për tarifën.

Pas datës së paraqitjes së aplikimit për tarifa, por përpara dhënies së vendimit përkatës nga ERE, disa prej këtyre parametrave dhe supozimeve mund të përditësohen - për shembull, çmimi i energjisë elektrike dhe parashikimi i kërkesës. Në supozojmë se gjatë vlerësimit të këtij aplikimi për tarifa, ERE do të marrë automatikisht në konsideratë vlerën e përditësuar të parametrave dhe supozimeve.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

Gjithashtu, ky aplikim për tarifa është i bazuar në kuadrin aktual rregullator shqiptar dhe interpretimin e tij prevalues. Megjithatë, ne jemi të vetëdijshëm për faktin se disa ndryshime të konsiderueshme në sektorin e ligjit ekzistues të energjisë janë diskutuar dhe përfshirja e legjislacionit të ri për energjinë, si për shembull, ligji për burimet e rinovueshme të energjisë është duke u përgatitur. Ka shumë gjasa që këto ndryshime të ligjeve ekzistuese, si dhe përfshirja e ligjeve të reja do të sjellin apo krijojnë detyrime të reja për CEZ Shpërndarje. Megjithatë, për momentin, nuk është e mundur të identifikohen të gjitha pasojat e mundshme të drejtpërdrejta ose të tërthorta të këtyre detyrimeve për CEZ Shpërndarje , të llogaritet ndikimi i tyre i përgjithshëm dhe të reflektohen ata në këtë aplikim për tarifa. Për shembull, sipas draftit aktual të Ligjit për Sektorin e Energjisë, CEZ Shpërndarje është e detyruar të mbartë përgjegjësi për lidhje në rrjet, gjë që do të rezultojë, me shumë gjasa, në OPEX më të larta, të cilat nuk janë përfshirë në llogaritjet e paraqitura. Tema tjetër e hapur është detyrimi i për “unbundling” e kompanisë, çka do të sjellë patjetër kosto të larta për kompaninë. CEZ Shpërndarje pret që, me miratimin e ndryshimeve të tilla në kuadrin aktual rregullator, ERE, së bashku me CEZ Shpërndarje , do të rishikojnë tarifën ekzistuese dhe do t’i përshtatin ato.

Ky aplikim për tarifa është paraqitur për periudhën 2012 - 2014. Ai është bazuar në kuadrin aktual rregullator dhe merr në konsideratë organizimin aktual të sektorit të energjisë në tregun shqiptar. Disa ndryshime në kuadrin rregullator, të cilët janë parashikuar tashmë ose janë në proces diskutimi dhe mund të përfshihen gjatë kësaj periudhe 3-vjeçare, do të kenë ndikim themelor në operacionet e biznesit të CEZ Shpërndarje .

Veçanërisht, këto ndryshime kanë të bëjnë me ligjin për sektorin e energjisë dhe me ligjin për burimet e rinovueshme të energjisë. Për shembull, liberalizimi i mëtejshëm i tregut dhe ulja e ndjeshme e numrit të konsumatorëve tarifore do të rezultojnë në ndryshime të konsiderueshme të çmimit për një sërë grupesh të caktuara të konsumatorëve për shkak të bazës të ndryshme të shpërndarjes së borxhit të keq. Nëse përfshihen ndryshime të tilla themelore, CEZ Shpërndarje do të ketë të drejtën të kërkojë rivlerësimin e parimeve rregullatore ose, sipas rastit, edhe të deklaratës rregullatore.

11.9. Mbështjettja e konsumatorëve në nevojë nëpërmjet tarifës së bllokut të parë

Në mënyrë të ngjashme, siç ka ndodhur në vitet e fundit, ne do të dëshironim t’ju sjellim në vëmendjen tuaj në matjen ekzistuese, sipas së cilës konsumi i 300 KWh të parë për të gjithë konsumatorët familjarë tariforet më lirë (“Blloku i parë i matjes”). Siç e kuptojmë, matja e bllokut të parë ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve të varfër dhe në nevojë (“konsumatorët vulnerabël”). Sigurisht që kjo mbrojtje është e nevojshme dhe duhet të ekzistojë në disa forma. Megjithatë, duke marrë në konsideratë sistemet e mbrojtjes që zbatohen në vende të tjera evropiane dhe legjislacionit lidhur me të, duket se blloku i parë ekzistues (i) nuk ofron mbrojtje efektive të konsumatorëve vulnerabël; (ii) sjell efekt shqetësues mbi tregun e energjisë, dhe (iii) mund të konsiderohen si shkelje të legjislacionit ekzistues evropian. Duke marrë në konsideratë interesin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, shprehur edhe në aplikimin e saj zyrtar për anëtarësimin që është paraqitur në

vitin 2009, si edhe statusi i saj aktual i vendit kandidat potencial për në BE, ne besojmë se është në interesin e Shqipërisë që të tentojë të harmonizojë gradualisht legjislacionin e vet me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Rezervat tona kryesora ndaj matjes së bllokut të parë janë si më poshtë:

Matje jo-sistematike dhe jo-efektive për mbrojtjen e konsumatorëve vulnerabël.

Sipas paragrafit nr. 53 të Direktivës 2009/72/EC të Parlamentit Evropian dhe Komisionin që merret me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë ("Direktiva"), "Shtetet Anëtare duhet të hartojnë plane-veprimi kombëtare ose kuadro të tjera të përshtatshme për të luftuar varfërinë, të cilat synojnë në uljen e numrit të njerëzve në nevojë. Qasja e integritit, si p.sh. kuadri i politikave sociale, duhet të zbatohet dhe duhet të përfshijë politika sociale ose përmirësime të efikasitetit të energjisë për strehimin."

Përveç kësaj, sipas Nenit 3 (8) të Direktivës, "Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura, të tilla si formulimi i planeve kombëtare të veprimit në fushën e energjisë, duke garantuar përfitime në sistemet e sigurimeve sociale për të mundësuar furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve vulnerabël, ose duke ofruar mbështetje për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, për të trajtuar problematikat e identifikuara të njerëzve në nevojë në lidhje me energjisë, duke përfshirë të gjithë kontekstin e varfërisë".

Me sa jemi në dijeni, nuk ekzistojnë plane të tillë veprimi të miratuar dhe instrumente të tjera të këtij lloji ende nuk zbatohen në Shqipëri, për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. Megjithatë, disa parime të reja janë gati për t'u përfshirë në të ardhmen e afër në rregulloren e re të sektorit të energjisë. Kështu, këto parime janë në kundërshtim me matjen ekzistuese të bllokut të parë.

Drafti i ri i ligjit shqiptar për energjinë ("Drafti") parashikon që një program do të hartohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (në konsultim me ERE) në mënyrë që të ndihmojë konsumatorët në nevojë. Ky program do të duhet të jetë në përputhje me disa kritere, duke përfshirë faktin se mbështetja duhet të bazohet në nevojat ekonomike të familjeve që duhet të mbështeten.

Ne jemi të mendimit se matja e bllokut të parë nuk garanton mbrojtje efektive për konsumatorët në nevojë, si p.sh. çmim më të ulët është i zbatueshëm për të gjithë konsumatorët familjarë, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike dhe sociale. Kjo lejon që të gjithë konsumatorët, jo vetëm ata në nevojë, të përfitojnë nga blloku i parë, çka është në kundërshtim me filozofinë themelore të sistemeve të mbrojtjes efektive të zbatuar në vendet evropiane.

Mosarritja për të garantuar tarifa jo-diskriminuese dhe tarifa që reflektojnë kostot

Në bazë të Direktivës, autoritetet kombëtare rregullatore duhet të sigurojnë që transmetimi i miratuar dhe tarifat e shpërndarjes të jenë jo-diskriminuese dhe të reflektojnë kostot. Sipas draftit, programi për të ndihmuar konsumatorët familjarë në nevojë duhet të përputhet me kriteret e caktuara. Këto

kritere përfshijnë faktin se mbështetja e drejtpërdrejtë duhet (i) të krijohet nga burimet të të ardhurave, (ii) të realizohet në mënyrë jo-diskriminuese, dhe (iii) të mos jetë i financuar nga konsumatorët.

Në këtë moment, matja e bllokut të parë është aplikuar gjerësisht për të gjithë konsumatorët, çka do të thotë se konsumi i të gjithë konsumatorëve deri në 300 KWh e para është me çmim më të ulët. Kjo rezulton në çmim më të lartë të aplikueshëm për pjesën e mbetur të konsumit (mbi 300 KWh), e cila është e nevojshme në mënyrë që të kompensojë diferencën në çmim. Me shumë gjasa ky parim mund të interpretohet si masë diskriminuese ndaj konsumatorëve me konsum më të lartë dhe konsumatorët e kategorive të tjera dhe për rrjedhojë, kjo praktikë nuk është në përputhje me kërkesat e mësipërme të Direktivës dhe Draftit.

Mosarritje për të parandaluar subvencionimin e kryqëzuar (cross-subsidization)

Sipas Direktivës, një nga parimet kryesore që duhet të respektohet në lidhje me mbështetjen e konsumatorëve në nevojë është eliminimi i subvencionimit të kryqëzuar. Sipas mendimit tonë, është mjaft e mundshme që matja e bllokut të parë do të konsiderohet se nuk është në përputhje me këtë parim. Çmimi më i ulët për 300 KWh e para të konsumit duhet të kompensohet me tarifë më të lartë për konsumin e mbetur dhe me tarifë më të lartë për grupet e tjera të konsumatorëve.

Në përputhje me Direktivën, programi i ri sugjeron që programi për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë duhet të eliminojë çdo subvencion të kryqëzuar nga tarifat dhe çmimet. Programi dhe sistemi i ri i mbrojtje së konsumatorit, që duhet të krijohet për këtë arsye, duhet të shmangin krijimin ose ruajtjen e parimeve, të cilat mund të interpretohen si subvencionime të kryqëzuara, duke përfshirë edhe matjen e bllokut të parë ose çdo matje tjetër të kësaj natyre.

Mungesa e inkurajimit për përdorimin eficient të energjisë

Në këtë moment, drafti i ligjit për efizienzën e energjisë është duke u diskutuar. Sipas tij, shteti shqiptar duhet të krijojë kuadrin ligjor që do të promovojë dhe përmirësojë përdorimin efikas të energjisë. Edhe pse ky ligj synon të mbulojë çështje të ndryshme, të cilat mund të kontribuojnë në uljen e ndjeshme të përdorimit të energjisë, ai dëshmon qartë se Shqipëria njeh rëndësinë e qasjes për konsumin e energjisë dhe është e përgatitur të marrë përsipër përgjegjësinë për përmbushjen e objektivit të kursimit të energjisë kombëtare.

Matja e bllokut të parë është kundër këtij qëllimi për të krijuar ambient ligjor që do të inkurajonte përdorimin efikas të energjisë. Çmimi më i ulët për 300 KWh të parë kontribuon në sjelljen e papërgjegjshme të konsumatorëve dhe shpërdorim të paarsyeshëm të energjisë, të paktën deri në konsumin e 300 KWh të para. Në rast se hiqet matja e bllokut të parë, është shumë e mundshme që konsumatorët do të bëhen më të kujdesshëm në lidhje me konsumin e energjisë së tyre dhe do të reagojnë më mirë ndaj aktiviteteve të ardhshme shtetërore me qëllim rritjen e përdorimit të eficientës së energjisë.

Aplikimi i tarifave 2012-2014

Pavarësisht të gjitha rezervave tona dhe komenteve rreth matjes së bllokut të parë, siç u shpjegua më sipër, për momentin, duke marrë parasysh formulimin aktual të draftit të ri të legjislacionit, ne nuk propozojmë heqjen e matjes së bllokut të parë. Drafti paraqet parimet e një mbështetjeje të re dhe sistemit të mbrojtjes së konsumatorit, të cilat duket se janë në përputhje me parimet kryesore të legjislacionit evropian. Edhe pse për detajet e mbështetjes dhe sistemit të mbrojtjes, të cilat do të fokusohen në mënyrë rigoroze mbi konsumatorët në nevojë, nuk është rënë ende dakord, ne presim që shteti shqiptar, si edhe të gjitha autoritetet përkatëse do të fillojë së shpejti punën intensive për krijimin e këtij sistemi. CEZ Shpërndarje është e gatshme të ofrojë përvijën e kompanive të tjera që i përkasin CEZ Group-it dhe të marrë pjesë aktive në hartimin dhe vendosjen e sistemit të ri që, siç edhe presim, do të mundësojë së shpejti heqjen e matjes së bllokut të parë dhe zëvendësimin e saj me një sistem i ri efektiv.

11.10 Llogaritja e tarifave për kategoritë e konsumatorëve

CEZ Shpërndarje sh.a ka interes që të japë alokime të drejta për pjesën e shpërndarjes së aktivitetit dhe pjesën e furnizimit të aktivitetit. Hapi i dytë është alokimi në nivele të ndryshme tensioni. Hapi i tretë është alokimi i klientëve në grupe të ndryshme.

Hapi i parë - alokimi në shpërndarjen dhe aktivitetin e Furnizimit (licencë) është bërë dhe mund të themi se të Ardhurat e Kërkuara nga Shpërndarja dhe Furnizimi janë krijuar në përputhje të plotë me dy aktivitete të ndryshme licencash.

Hapi i dytë dhe i tretë - alokimi për nivele të ndryshme tensioni dhe për grupe klientësh është bërë nga tarifat e shpërndarjes dhe alokimi është bërë duke u bazuar në pikat e mëposhtme:

- Energjia e pritshme e shpërndarë në TL, TM dhe TU – e përdorur për ndarjen e shpërndarjes OPEX dhe mekanizmin e kompensimit .
- Humbje të pritshme teknike dhe jo-teknike në TL, TM dhe TU- të përdorura për ndarjen e kostove të blerjes së humbjeve.
- Elementi i kombinuar (vlera e aseteve TL, TM dhe TU me energji të shpërndarë të pritshme në nivele tensioni) –përdorur për ndarjen e amortizimit dhe normën e kthimit të aseteve-nëpërmjet këtij çelësi respektohet premisa që asetet e nivelit të tensionit me të lartë përdoren nga konsumatorët edhe në nivel tensioni me të ulët (rrjedhja e energjisë)-me anë të këtij elementi, ka tre nderveprime për të arritur ndarjen përfundimtare;

Detaje të tjera për ndarjen e humbjeve midis niveleve të tensionit - me anën e këtij alokimi, ishin plotësisht në përputhje me pikën 7.1.1. te metodologjise se llogaritjes së tarifës së operatorit të sistemit shpërndarjes. Humbjet e plota teknike dhe jo-teknike janë ndarë në disa hapa;

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

- Ndarje për humbjet teknike dhe jo-teknike bazuar në Studimin për Humbjen, i realizuar nga PWC
- Humbjet teknike janë ndarë midis kategorive (humbje TU, transformatorë TM/TU humbje TM dhe transformatorë TL/TM) duke u bazuar tek Studimi i Humbjes i krijuar nga PWC.
- Humbjet jo-teknike u alokuan vetëm për nivelin TU (konsumatorët tariforë)

Me këtë alokim, ne mund të llogarisim koston e humbjeve në secilin nivel Tensioni.

Ndërkohë duke respektuar pikat kyçe të përmendura më lart, është bërë dhe llogaritja e çmimeve të niveleve të ndryshme të shpërndarjes në TL, TM dhe TU. Këto çmime/tarifa shpërndarjeje, duhen përdorur edhe në tregje potenciale të hapura (klientë të kualifikuar) dhe duhet të jenë uniforme. Me fjalë të tjera, nuk ka rëndësi nëse klienti është i mbrojtur ose i kualifikuar.

CEZ Shpërndarje sh.a, nuk e gjykon të arsyeshme ndarjen e tarifës së shpërndarjes sipas llojeve të ndryshme të klientëve.

Bazuar në sa u tha më lart, CEZ Shpërndarje sh.a propozon që tarifat e shpërndarjes për klientët e kualifikuar duhen caktuar në të njëjtin nivel sipas klientëve tariforë në nivele Tensioni të Lartë dhe të Mesëm. Do të donim të theksonim se këto tarifa nuk përfshijnë humbjet jo-teknike.

Struktura aktuale e tarifave ekzistuese nuk lejon të vlerësosh qartë kërkesat e llojeve të ndryshme të klientëve të rrjetit shpërndarës.

Parë në këtë aspekt, ne propozojmë gjithashtu edhe çmim fiks për fuqi të instaluar në përputhje me një nga parametrat bazë të shpërndarjes që dikton ndërtimin e rrjetit të shpërndarjes - fuqisë shpërndarëse.

Duke pasur në fokus nivelin TM, është futur një komponent i ri, që do të thotë se të ardhurat e krijuara nga ky nivel tensioni janë të ndara në të ardhura variabile dhe fikse. Ose mund të themi që tek çmimi variabël janë alokuar të ardhurat, pa të ardhurat e mbuluara nga çmimi fiks.

Hapi i dytë dhe i tretë i tarifave të Furnizimit nuk është bërë. Alokimi i drejtë do të sillte ndryshime në çmime midis niveleve të tensionit dhe tarifave përkatëse. Parë nga ky aspekt, alokimi është bërë mbi bazën e raportit historik (ekzistues) midis tarifave.

Jemi të vetëdijshëm se një ndryshim i tillë nuk mund të bëhet brenda vitit. Ne e respektojmë plotësisht rolin e ERE-s në përcaktimin e nivelit individual të tarifave përkatëse dhe jemi të gatshëm të diskutojmë skenarë të mundshëm të ndryshëm për alokimin e të Ardhurave të Kërkuara.

Bazuar në sa u tha më lart, CEZ Shpërndarje sh.a, do të donte të vinte theksin mbi përdorimin e rregullave të mëposhtme për tarifat e propozuara:

Aplikimi i tarifave 2012-2014

CEZ Shpërndarje, Sh.a.; Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Palati 12/1, Tirana, Shqipëri

- Mos subvencionim i kryqëzuar midis shpërndarjes dhe aktivitetit të licencës së shitjes .
- Paraqitja e çmimit fiks në tarifat e shpërndarjes.
- Të ndahen të ardhurat e kërkuara të shpërndarjes nëpërmjet tarifave të ndryshme të shpërndarjes në secilin nivel tensioni.
- Të aplikohet struktura aktuale e tarifës në aktivitetin e furnizimit.

CEZ Shpërndarje sh.a, do të donte gjithashtu të diskutonte me ERE-n mbi mundësinë e thjeshtimit të strukturës së tarifave ekzistuese. Ekzistenca e 6 kategorive konsumatore me çmime të ndryshme, nuk ka bazë teknike dhe ekonomike në një biznes të shpërndarjes së energjisë.

Tarifat përkatëse janë bashkangjitur në **Shtojcën nr. 6**.

CONFIDENTIAL

Lista e Shtojcave

Shënim: Shtojcat 3 dhe 7 do të trajtohen si konfidenciale

Shtojca Nr. 1 – Bilanci i energjisë së parashikuar për 2011-12, përfshirë numrin e parashikuar të konsumatorëve

Shtojca Nr. 2 – Metodologjia HDD&CDD

Shtojca Nr. 3 – Përmbledhje e evolucionit të shpenzimeve të përgjithshme operationale

Shtojca Nr. 4 – Përmbledhje grafike e principeve të perlllogaritjes së kostove të amortizimit

Shtojca Nr. 5 – Llogaritja e humbjeve për matjen e lokalizuar në anën sekondare të transformatorëve

Shtojca Nr. 6 – Struktura e propozuar e tarifave për 2012

Shtojca Nr. 7 – Organigrama për vitet 2011 dhe 2012

Shtojca Nr. 1 – Bilanci i energjisë së parashikuar për 2011-12, përfshirë numrin e parashikuar të konsumatorëve

New Energy Balance expectation 2011

	DISTRIBUTION		SUPPLY	
	No of Customer	Distributed energy (MWh)	No of Customer	Sales energy (MWh)
Customers at TSO - Kurum	base 0	0	3	461 015
peak 0	0	0	3	141 948
total 0	0	0	3	602 964
Customers at 110 kV	base 3	69 538	3	69 538
peak 3	69 538	3	69 538	0
total 0	0	0	0	0
Industry	base 3	69 538	3	69 538
peak 3	69 538	3	69 538	0
total 0	0	0	0	0
Commerce and Services	base 0	0	0	0
peak 0	0	0	0	0
total 0	0	0	0	0
Agriculture	base 0	0	0	0
peak 0	0	0	0	0
total 0	0	0	0	0
Others	base 0	0	0	0
peak 0	0	0	0	0
total 0	0	0	0	0
Customers at 35 kV	base 3	69 538	3	69 538
peak 3	69 538	3	69 538	0
total 0	0	0	0	0
Industry	base 14	4 603	14	4 603
peak 14	4 603	14	4 399	0
total 14	5 042	14	5 042	0
Commerce and Services	base 61	31 385	61	31 385
peak 61	4 002	61	4 002	0
total 61	35 387	61	35 387	0
Agriculture	base 0	0	0	0
peak 0	0	0	0	0
total 0	0	0	0	0
Others	base 3	4 307	3	4 307
peak 3	2 635	3	2 635	0
total 3	6 942	3	6 942	0
Customers at 20/10/6 kV	base 78	47 371	78	47 371
peak 78	47 371	78	47 371	0
total 78	47 371	78	47 371	0
Industry	base 2 304	314 757	2 304	314 757
peak 2 304	27 513	2 304	27 513	0
total 2 304	342 270	2 304	342 270	0
Commerce and Services	base 2 477	162 035	2 477	162 035
peak 2 477	18 397	2 477	18 397	0
total 2 477	180 432	2 477	180 432	0
Wheat industry and bakeries	base 111	7 831	111	7 831
peak 111	1 080	111	1 080	0
total 111	8 912	111	8 912	0
Agriculture	base 95	741	95	741
peak 95	82	95	82	0
total 95	822	95	822	0
Others	base 568	182 111	568	182 111
peak 568	20 356	568	20 356	0
total 568	202 467	568	202 467	0
Budgetary	base 313	44 438	313	44 438
peak 313	2 616	313	2 616	0
total 313	47 054	313	47 054	0
Customers at 0,4 kV Commercial	base 5 869	781 958	5 869	781 958
peak 5 869	781 958	5 869	781 958	0
total 5 869	781 958	5 869	781 958	0
Industry	base 42	6 713	42	6 713
peak 42	6 713	42	6 713	0
total 42	6 713	42	6 713	0
Commerce and Services	base 134 043	663 427	134 043	663 427
peak 134 043	663 427	134 043	663 427	0
total 134 043	663 427	134 043	663 427	0
Wheat industry and bakeries	base 2 811	33 386	2 811	33 386
peak 2 811	33 386	2 811	33 386	0
total 2 811	33 386	2 811	33 386	0
Agriculture	base 2 523	2 580	2 523	2 580
peak 2 523	2 580	2 523	2 580	0
total 2 523	2 580	2 523	2 580	0
Others	base 4 294	91 885	4 294	91 885
peak 4 294	91 885	4 294	91 885	0
total 4 294	91 885	4 294	91 885	0
Budgetary	base 8 343	134 493	8 343	134 493
peak 8 343	134 493	8 343	134 493	0
total 8 343	134 493	8 343	134 493	0
Residential	base 152 056	932 484	152 056	932 484
peak 790 635	1 811 788	790 635	1 811 788	0
>300 kWh 222 371	836 178	222 371	836 178	0
Common spaces 0	51 644	0	51 644	0
TOTAL	1 013 006	2 699 609	1 013 006	2 699 609

Own consumption 285 6 593 285 6 593
 Own consumption is not included in energy balance - it is part of OPEX for Distribution electricity is purchased via Supply (for WPS price) and internally recharge to Distribution
TOTAL 1 171 012 4 530 960 1 171 012 5 133 923
 -602 964

	DISTRIBUTION		SUPPLY	
	No of Customer	Distributed energy (MWh)	No of Customer	Sales energy (MWh)
Total power outflow/consumed	1 171 012	4 530 960	1 171 012	5 133 923
Allowed loss rate		27,92%		
Losses		1 756 056		
Total power inflow/purchased		6 286 016		5 133 923
110 kV-connected TSO	0	0	0	0
Subtotals				
HV - 220 kV	0	0	3	602 964
HV - 110 kV	3	69 538	3	69 538
MV - 35 kV	78	47 371	78	47 371
MV - 20/10/6 kV	5 869	781 958	5 869	781 958
LV Commercial	152 056	932 484	152 056	932 484
LV Residential	1 013 006	2 699 609	1 013 006	2 699 609
TOTAL	1 171 012	4 530 960	1 171 012	5 133 923

Energy Balance 2012

	DISTRIBUTION		SUPPLY	
	No of Customer	Distributed energy (MWh)	No of Customer	Sales energy (MWh)
Customers at TSO - Kurum	base 0	0	3	478 513
peak 0	0	0	3	146 940
total 0	0	0	3	625 453
Customers at 110 kV	base 2	73 015	3	193 015
peak 2	73 015	3	193 015	0
total 2	73 015	3	193 015	0
Industry	base 2	73 015	3	193 015
peak 2	73 015	3	193 015	0
total 2	73 015	3	193 015	0
Commerce and Services	base 0	0	0	0
peak 0	0	0	0	0
total 0	0	0	0	0
Agriculture	base 0	0	0	0
peak 0	0	0	0	0
total 0	0	0	0	0
Others	base 0	0	0	0
peak 0	0	0	0	0
total 0	0	0	0	0
Customers at 35 kV	base 2	73 015	3	193 015
peak 2	73 015	3	193 015	0
total 2	73 015	3	193 015	0
Industry	base 14	4 603	14	4 603
peak 14	4 603	14	4 399	0
total 14	5 042	14	5 042	0
Commerce and Services	base 61	31 316	61	31 316
peak 61	4 029	61	4 029	0
total 61	35 545	61	35 545	0
Agriculture	base 0	0	0	0
peak 0	0	0	0	0
total 0	0	0	0	0
Others	base 3	4 311	3	4 311
peak 3	2 638	3	2 638	0
total 3	6 949	3	6 949	0
Customers at 20/10/6 kV	base 78	47 536	78	47 536
peak 78	47 536	78	47 536	0
total 78	47 536	78	47 536	0
Industry	base 2 470	354 523	2 470	354 523
peak 2 470	30 777	2 470	30 777	0
total 2 470	385 299	2 470	385 299	0
Commerce and Services	base 2 656	213 637	2 656	213 637
